



Lehtësia për Përafrimin me Acquis të BE

Mbështetje e mëtutjeshme zhvillimit të tregtisë në Kosovë

**Nr. Identifikues i Projektit
EuropeAid/138565/DH/SER/XK
Kontratë Shërbimi Nr. 2018/395-320**

**Vlerësimi i Detyrimeve të Kosovës që Dalin nga
Protokolli Shtesë 6 për Tregtinë e Shërbimeve**

14 Tetor, 2019



Kontakt personat tuaj brenda
GFA Consulting Group GmbH janë

Z-sha Martina Bernauer (Drejtor Projekti)
Z. Luis Abugattas (Udhëheqës Ekipi)

Kosovë

**Mbështetje e mëtutjeshme zhvillimit të
tregtisë në Kosovë**

Kontrata Numër 2018/395-320

Raport i Misionit të ESASH

Akt. nr. 1.3.2 – Vlerësimi i Detyrimeve të Kosovës që Dalin nga Hyrja në Fuqi e “Protokollit
Shtesë 6 për Tregtinë e Shërbimeve në Marrëveshjen për Ndryshim/Plotësimin e dhe
Aderimin në Marrëveshjen e Europës Qendrore për Tregti të Lirë”

Drafti i Parë i Dokumentit për diskutim

Autori

Z. Luis Abugattas – Udhëheqës Ekipi i Projektit

Data: 14.10.2019

Mohim

Ky publikim është nxjerrë me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorit dhe GFA Consulting Group GmbH dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian

GFA Consulting Group GmbH

Eulenkrogstr. 82
D-22359 Hamburg
Gjermani

Tel: +49 (40) 6 03 06 170
Fax: +49 (40) 6 03 06 159
E-mail: martina.bernauer@gfa-group.de

I. Hyrje

Pas një procesi të zgjatur negociues mbi kornizën regjionale për liberalizim të tregtisë së shërbimeve, Anëtarët e CEFTA-s përfundimisht u pajtuan, gjatë takimit në Tiranë më 18 mars 2019, për tekstin përfundimtar të *“Protokolli Shtesë 6 për Tregtinë e Shërbimeve në Marrëveshjen për Ndryshim/Plotësimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Europës Qendrore për Tregti të Lirë”* (PSH 6), dhe për zotimet specifike të cilat do t’i miratojë secili vend, që synon liberalizimin e detyrueshëm midis tyre. Teksti përfundimtar dhe shtojcat e PSH 6 ende nuk janë miratuar zyrtarisht nga instancat kompetente vendim marrëse të CEFTA-s. Qeveria e Kosovës miratoi vendimin i cili autorizon nënshkrimin e PSH 6 me 14 maj 2019.

Ky dokument ka për qëllim të jep dhe pasqyrojë zotimet e miratuara nga Kosova në kornizën e PSH 6, i cili bën një analizë të çështjeve më të gjera dhe të implikimeve në fjalë në lidhje me obligimet detyruese të cilat Kosova i ka miratuar për tregtinë e shërbimeve. Ai gjithashtu përpiqet të identifikojë çfarë pune juridike dhe rregullatore do të nevojitej, nëse ka, me qëllim që të përmbushen obligimet detyruese të miratuara ligjërisht. Përveç kësaj, ky dokument shërben edhe si një udhëzues për PSH 6 për ata që nuk e njohin procesin negociues i cili u zhvillua dhe rezultatin përfundimtar.

Obligimet detyruese të miratuara nga Anëtarët e CEFTA-s në kuadër të PSH 6 lidhur me “masat e miratuara apo të mbajtura nga Palët që prekin tregtinë e shërbimeve” përbëhen nga tre grupe të gjera: I pari, obligimet e përgjithshme, të cilat vlejnë drejtpërdrejtë dhe automatikisht për të gjithë anëtarët dhe për të gjithë sektorët e shërbimeve; i dyti, obligimet e përgjithshme që vlejnë vetëm për ato shërbime ku zotimet specifike janë regjistruar në planin e anëtarëve; dhe së fundmi obligimet specifike që kanë të bëjnë me qasjen në treg dhe trajtimin kombëtar të regjistruara në sektorë të caktuar. Këto zotime specifike përcaktohen në *“Programi i Konsoliduar i Zotimeve Specifike për Tregtinë e Shërbimeve të Palëve të CEFTA-s”* (Shtojca 3 e PSH 6)¹. Edhe pse zotimet specifike të çdo vendi të CEFTA-s ndryshojnë deri diku, mund të vërehet një shkallë domethënëse e ngjashmërisë lidhur me shtrirjen dhe thellësinë e zotimeve specifike të miratuara nga të gjithë anëtarët.

PSH 6 u modelua sipas *“Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë e Shërbimeve”* (GATS) të OBT-s, e cila përfshin shumë nga dispozitat e përgjithshme të saj, si dhe qasjen e planifikuar të “renditjes pozitive” për miratim të zotimeve specifike. Mirëpo, janë bërë disa ndryshime dhe disa nga dispozitat që gjenden në GATS mungojnë nga PSH 6. Duke pasur parasyshë ngjashmërinë e dispozitave kryesore dhe qasjen për planifikim të zotimeve specifike, të cilat përcaktojnë modelin e përgjithshëm të liberalizimit, praktika dhe jurisprudenca e GATS-it janë mjaft të përshtatshme për të vlerësuar çështje më të gjera, si dhe shtrirjen dhe thellësinë e zotimeve të miratuara në bazë të PSH 6. Në këtë drejtim duhet të theksojmë faktin se miratimi i modelit të GATS-it ka transpozuar edhe në PSH 6 shumë nga çështjet që mbeten të pazgjadhura dhe varen nga interpretime të ndryshme në lidhje me dispozitat e ndryshme të GATS-it.

Ky dokument, në Pjesën II shtjellon shkurtimisht konceptet themelore të përfshira në PSH 6 siç rrjedhin nga GATS-i, më pas në Pjesën III vazhdohet të shtjellohen obligimet e përgjithshme kryesore, që dalin për PSH 6 dhe implikimet potenciale për Kosovën nga hyrja në fuqi e saj. Pjesa IV shtjellon obligimet e përgjithshme që vlejnë vetëm për sektorët në të cilët janë miratuar zotimet

¹ Versioni final 2 prill 2019.

specifike. Pjesa V paraqet dhe vlerëson zotimet specifike të miratuara nga Kosova në Shtojcën 3 të PSH 6. Në fund, Pjesa VI paraqet disa komente përmbyllëse dhe rekomandime.

II. Konceptet Themelore

PSH 6 ka përfshirë përkufizimet, konceptet kryesore dhe strukturën e përgjithshme të GATS-it. Për ta ndjekur shtjellimin e paraqitur në këtë dokument, është me rëndësi që shkurtimisht të përsëriten disa koncepte të rëndësishme, që realizon vet strukturën dhe funksionimin e PSH 6. Që në fillim duhet të theksohet se PSH 6 është i gjerë në shtrirje dhe në thellësi. Ai përfshin të gjitha shërbimet, përveç ato të parashikuara në ushtrimin e autoritetit qeveritar dhe disa shërbime të transportit ajror dhe përfshin të gjitha masat qoftë në formën e një ligji, rregulloreje, rregulle, procedure, vendimi, veprimi administrativ apo çdo lloj forme që prek tregtinë e shërbimeve të miratuara nga cilido nivel i qeverisë dhe nga subjektet me fuqi deleguese për të vepruar.² Siç shpjegohet në rastin Banana, qëllimi i GATS-it përfshin çdo masë të një Anëtarit në masën që ndikon në ofrimin e një shërbimi, pavarësisht nëse kjo masë rregullon drejtpërdrejtë ofrimin e një shërbimi ose nëse ajo rregullon çështje të tjera, por megjithatë ndikon në tregtinë e shërbimeve. Prandaj, GATS-i është gjithëpërfshirës dhe pothuaj çdo lloj intervenimi shtetëror, në masën që prek tregtinë e shërbimeve, bën pjesë në të. Duhet të kuptojmë se qëllimi i konceptit është i ngjashëm në PSH 6.

2.1 Tregtia e Shërbimeve

Neni 2. 2, për qëllime të Protokollit, pas praktikës së GATS-it, e përkufizon tregtinë e shërbimeve si ofrim të një shërbimi:

- (a) nga territori i një Pale në territorin e një Pale tjetër (Modaliteti 1);
- (b) në territorin e një Pale tek konsumatori i shërbimit të çdo Palë tjetër (Modaliteti 2);
- (c) nga një ofrues shërbimi të një Pale, përmes pranisë komerciale në territorin e një Pale tjetër (Modaliteti 3);
- (d) nga një ofrues shërbimi të një Pale, përmes pranisë së personave fizik të një Pale në territorin e çdo Pale tjetër (Modaliteti 4).³

2.2 Qasja në Treg

Kufizimet e qasjes në treg, siç përcaktohet në Nenin 4 të PSH 6, i cili drejtpërdrejtë transpozoi listën nga Neni XVI i GATS mund të jenë diskriminuese ose jodiskriminuese. Katër nga gjashtë llojet e masave të renditura në Nenin 4.2 janë të natyrës sasiore, sa i përket kufizimeve të: (a) numrit total të ofruesve të shërbimeve; (b) vlerës totale të transaksioneve ose asetëve të shërbimeve; (c) numrit total të operacioneve të shërbimeve apo sasisë totale të prodhimit të shërbimeve; dhe (d) numrit total të personave fizik që mund të jenë të punësuar në një sektor të caktuar shërbimi apo të cilin një ofrues shërbimi mund ta punësojë. Masat përkatëse mund të përbëhen jo vetëm nga kuotat numerike apo, në rastin e 4.2(a), të monopoleve dhe ujdive ekskluzive, por përfshijnë kërkesën për testim të nevojave ekonomike. Duhet theksuar se nuk janë

² Masat nga Palët që prekin tregtinë e shërbimeve " përfshijnë masat për: (i) blerje, pagesë ose shfrytëzim të një shërbimi; (ii) qasja në dhe shfrytëzimi i, në lidhje me ofrimin e një shërbimi, shërbimet që kërkohen nga ato Palë to ofrohen për publikun në përgjithësi; (iii) prania, përfshirë praninë komerciale, të personave të një Pale për ofrim të një shërbimi në territorin e Palës tjetër (Neni 1.1c.)

³ Teknikisht, mënyra 4 përkufizohet në Nenin I.2(d) të GATS si "ofrim i një shërbimi... nga një ofrues shërbimi të një Anëtarit, përmes pranisë së personave fizik të një Anëtarit në territorin e Anëtarit tjetër ". Ky përkufizim zbatohet për shtetasit si dhe, në rrethanë të caktuara, rezidentët të përhershëm, të Anëtarëve të OBT-s, që kërkojnë të ofrojnë shërbime jashtë vendit (rezidentët e përhershëm përfshihen ku Anëtarit nuk ka shtetas ose ofron në thelb të njëjtin trajtim për rezidentët e përhershëm dhe shtetasit) [Neni XXVIII(k)]

përfshirë pragjet minimale, si madhësia minimale apo kërkesat minimale të kapitalit. Përveç kësaj, Neni 4.2 (e) mbledh masat të cilat kufizojnë apo kërkojnë lloje specifike të subjektit juridik ose të ndërmarrjes së përbashkët, përderisa 4.2(f) ka të bëjë me kufizimet e pjesëmarrjes së kapitalit të huaj për sa i përket kufijve të përqindjes maksimale të aksioneve të huaja apo vlerës së investimit të huaj.

Kufizimet e qasjes në treg përbëhen nga masat e një Anëtar, pasi të ketë nënshkruar një zotim specifik sektorial, nuk duhet ta miratojë ose mbaj 'përveç nëse ndryshe specifikohet në Planin e tij'. Jurisprudenca sipas GATS-it konfirmon qartë se lista e masave të përfshira në Nenin XVI përmban të gjitha masat që duhet të merren parasysh si kufizime të qasjes në treg. Do të thotë, vargu i kufizimeve të mundshme për qasje në treg janë vetëm ato të renditura në paragrafin 2 të Nenit XVI.⁴ Në të njëjtën mënyrë, Udhëzuesit për Planifikim të GATS (S/L/92, para 8) në mënyrë të qartë vërtetojnë se është shterruar lista e kufizimeve të qasjes në treg në Nenin XVI: 2.⁵ Prandaj, ky duhet të jetë edhe rasti në PSH 6.

2.3 Trajtimi Kombëtar

Trajtimi kombëtar, siç parashikohet në Nenin 5 të PSH 6, nënkupton se shërbimeve dhe ofruesve të huaj të shërbimeve të ngjashme u jepet trajtim jo më pak favorizues se sa ai që u jepet shërbimeve dhe ofruesve vendor të shërbimeve. Përfituesit e trajtimit kombëtar janë si shërbimet, ashtu edhe ofruesit e shërbimeve. Shërbimet në GATS përkufizohen në Nenin I(3)(b), "shërbimet përfshijnë çdo shërbim në të gjithë sektorët përveç shërbimeve të ofruara në ushtrimin e autoritetit qeveritar". PSH 6 në Nenin 2(3)(b)I përfshijnë një përkufizim të ngjashëm të shërbimeve. PSH 6, si GATS, përkufizojnë ofruesin e shërbimeve në Nenin 1(g) si "çdo person fizik ose juridik që ofron një shërbim". Trajtimit kombëtar mund t'u jepet edhe degëve dhe zyrove përfaqësuese të ofruesve të shërbimeve.

Nuk ka asnjë detyrim për t'i ofruar trajtim identik shërbimeve dhe ofruesve të huaj të shërbimeve. Trajtimi kombëtar mund të rezultojë nga trajtimi formalisht identik ose formalisht i ndryshëm. Testi kryesor i trajtimit kombëtar është se masa në fjalë nuk i ndryshon kushtet e konkurrencës në favor të shërbimeve dhe ofruesve vendor të shërbimeve dhe ndaj të huajve. Trajtimi kombëtar mbulon diskriminimin si de jure, ashtu edhe de facto; që do të thotë se, nëse një masë zbatohet si për të huajt, ashtu edhe për vendorët, ajo akoma mund të jetë diskriminuese nëse efekti i saj është të bëjë diskriminim ndaj shërbimeve dhe ofruesve të huaj të shërbimeve. Mirëpo, trajtimi kombëtar nuk kërkon që një Anëtar të bëjë kompensimin për ndonjë disavantazh të qenësishëm konkurrues që vjen nga personi i huaj i shërbimit apo ofruesve përkatës të shërbimeve.

2.4 Subvencionet

Fusha ku PSH 6 largohet nga dispozitat e GATS është në lidhje me subvencionet. Neni 2.6 parashikon që Protokoli "nuk zbatohet për subvencione apo grante të dhëna nga një Palë, përfshirë kreditë, garancitë dhe sigurimin që mbështeten nga qeveria". Subvencionet për industrinë e shërbimeve konsiderohen "masa" në kuptimin e GATS; prandaj, ato përfshihen në marrëveshje dhe për këtë arsye i nënshtrohen detyrimeve të saj të përgjithshme, siç është KMF dhe mund të mbulohen, nëse dëshirohet, nga zotimet specifike të një Anëtar për Qasjen në Treg dhe Trajtimin Kombëtar. Nëse një Anëtar i OBT-s dëshiron të mbaj të drejtën e diskriminimit ndaj shërbimeve dhe ofruesve të huaj të shërbimeve në dhënien e subvencioneve, në një shërbim ku

⁴ Indeksi Analitik i OBT. GATS-Neni XVI (Jurisprudenca). Gjetet në: www.wto.org/english/res_e/publications_e/ai17_e/gats_art16_jur.pdf

⁵ Udhëzuesit për Planifikim të Zotimeve Specifike sipas Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë e Shërbimeve (GATS). OBT S/L/92, 28 Mars 2001. Miratuar nga Këshilli për Tregtinë e Shërbimeve me 23 Mars, 2001.

ai ka bërë zotime specifike, ai duhet ta shënojë atë kufizim në planin e tij.⁶ Përveç kësaj, Neni XV i GATS nxit Anëtarët të hyjnë në negociata me qëllim të eliminimit të efekteve të subvencioneve që mund të çrregullojnë tregtinë. Në rastin e PSH 6, subvencionet janë përjashtuar plotësisht nga marrëveshja, prandaj çdo anëtar mund t'u ofrojë çfarëdo lloj mbështetje që i duket e përshtatshme ofruesve të tij të shërbimeve. Ky përjashtim mund të kthehet në problematikë në të ardhmen, pasi mbështetja shtetërore për ofruesit e shërbimeve mund të ndikojë seriozisht në kushtet e konkurrencës ndërmjet vendeve në tregun e CEFTA-s.⁷ Për më tepër, pasi kjo lloj mase është plotësisht e përjashtuar nga PSH 6, nuk ka detyrim të transparencës, që do t'u lejonte anëtarëve të informohen mbi natyrën dhe shtrirjen e mbështetjes e cila do t'u ofrohej ofruesve të shërbimeve në secilin prej vendeve të CEFTA-s.

Në rastin e Kosovës, ndihma shtetërore rregullohet me Ligjin Nr 05/L-100 të vitit 2016 për Ndhimë Shtetërore, i cili ndalon çdo ndihmë, përveç siç përcaktohet me ligj dhe vendos kufizime dhe kushte të rrepta për miratimin e çdo mbështetjeje shtetërore për ndërmarrjet ekonomike në sektorët e prodhimit dhe të shërbimeve (Neni 2). Prandaj, çfarëdo ndihme që Kosova do të mund t'u ofronte ofruesve të shërbimeve duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të miratohet paraprakisht.⁸ Efektet e mundshme të subvencioneve që mund ta çrregullojnë tregtinë në tregtinë e shërbimeve ndër-rajonale të CEFTA-s do të minimizohej në atë masë sa të gjitha vendet anëtare të transpozojnë dhe zbatojnë me sukses *acquis*-n e BE-s në këtë fushë.

III. Detyrimet e Përgjithshme

PSH 6, i cili zbaton GATS-in, ka përfshirë detyrimet e gjera të përgjithshme, që burojnë nga GATS-i, të cilat do të zbatohen automatikisht pas hyrjes në fuqi për të gjithë anëtarët dhe të gjitha shërbimet e përfshira në marrëveshje. Mirëpo, janë bërë disa modifikime në fushëzbatimin e disa dispozitave dhe është përfshirë një detyrim i përgjithshëm i rëndësishëm që mungonte në GATS. Ne do t'i shtjellojmë këto detyrime shkurtimisht.

3.1 Trajtimi i Kombit më të Favorizuar

Parimi i mosdiskriminimit është thelbësor për rregullimin e tregtisë ndrëkombëtare. Detyrimet e përgjithshme të PSH 6 përfshijnë një zotim të menjëhershëm dhe të pakushtëzuar për trajtimin e kombit më të favorizuar (KMF) ndaj shërbimeve dhe ofruesve të shërbimeve të Anëtarëve të tjerë të CEFTA-s (Neni 3). Kjo do të thotë se Kosova i ofron trajtim jo më pak të favorshëm se më të mirin që ia ofron cilësdo palë për shërbimet dhe ofruesit e shërbimeve të ngjashme të vendeve të tjera të CEFTA-s. Kjo përbën në parim ndalimin e marrëveshjeve preferenciale ndërmjet grupeve të Anëtarëve në sektorë të caktuar ose të dispozitave të reciprocitetit të cilat kufizojnë përfitimet nga qasja në treg për partnerët tregtar që ofrojnë trajtim të ngjashëm.

Në lidhje me KMF, Ligji për Shërbime (Ligji Nr 05/L-130) mund të ketë implikime të caktuara të rëndësishme në lidhje me të drejtën e themelimit të ofruesve të shërbimeve në Kosovë (Modaliteti 3 nën PSH 6). Neni 6 i ligjit në fjalë garanton të drejtën e themelimit dhe qasjen në, ose ushtrimin

⁶ Paragrafi 10 i Dokumentit Shpjegues për Zotimet e Planifikuara thotë se Anëtarët nuk detyrohen të "marrin masa jashtë kompetencave të tyre territoriale. Prandaj del që detyrimi i Trajtimit Kombëtar në Nenin XVII nuk kërkon që Anëtari ta zgjerojë atë trajtim tek ofruesi i shërbimit që gjendet në territorin e një Anëtari tjetër" (dokumenti i OBT MTN.GNS/W/164, f. 4). Si rrjedhojë, dispozita e TK zbatohet vetëm për modalitetin 3, kur ofruesi i huaj mban një degë në vendin nikoqir.

⁷ Ndryshe nga rasti i GATS, PSH 6 nuk përfshin mandatin për negociata të ardhshme për subvencione mbi tregtinë e shërbimeve, i cili do të synonte shmangien e efekteve negative të masave të tilla në tregtinë e shërbimeve.

⁸ Ndhimja shtetërore mund të konsiderohet se është në përputhje me ligjin "kur jepet për të lehtësuar zhvillimin e fushave të caktuara ose aktiviteteve të caktuara ekonomike, përmes së cilës një ndihmë e tillë nuk ndikon në mënyrë të konsiderueshme në kushtet e tregtisë që bien në kundërshtim me interesin e përbashkët të përcaktuar në marrëveshjet e ratifikuara nga Republika e Kosovës" (Neni 6 (1.3)).

e veprimtarive të shërbimeve në Kosovë për ofruesit e huaj të shërbimeve të të gjitha vendeve. Prandaj, edhe nëse Kosova nuk ka bërë zotime specifike për themelim (Modaliteti 3) në planin e saj sipas PSH 6, ajo duhet të lejojë themelimin dhe ushtrimin e veprimtarisë për ofruesit e shërbimeve nga të gjitha vendet e CEFTA-s në të gjithë sektorët e shërbimeve të përfshira në Ligjin e Shërbimeve. Posa Kosova ta transpozojë të drejtën për ofrim të shërbimeve nga Direktiva e Shërbimeve e BE-s, do të ishte gjithashtu e detyrueshme të zgjerojë ato të drejta për të gjitha shërbimet dhe ofruesit e shërbimeve nga Anëtarët e CEFTA-s.

Përfshirja e integritimit ekonomik nga KMF i përfshirë në GATS përmes Nenit V, i cili u lejon trajtim preferencial palëve të një marrëveshjeje të tregtisë së lirë mbi shërbimet, nuk gjendet në PSH 6. Në këtë fushë, PSH 6 prezanton dispozitën *plus* të GATS, detyrimin për të hyrë në negociata me anëtarët e CEFTA-s në mënyrë që të zgjerohet trajtimi më i favorshëm që i ofrohet një pale të tretë. Përfshirja është i përhershëm në GATS dhe nuk ka detyrim për t'u përfshirë në negociata. Por, kjo është dispozitë e butë pasi që detyrimi për të hyrë në negociata nuk përjashton rezultatin e negociatave të tilla dhe PSH 6 fare nuk cekë se çfarë do të mund të bëhet në rast se negociatat në fund nuk janë frytdhënëse.

Aktualisht Kosova nuk ka negociuar asnjë marrëveshje që përfshin zotime specifike për tregtinë e shërbimeve prandaj nuk ka rrjedhoja të menjëhershme që dalin nga kjo dispozitë. Por, nëse Kosova negocion marrëveshjen e tregtisë së lirë mbi shërbimet në të ardhmen me një vend, ajo do të duhet që, me kërkesë të anëtarit tjetër të CEFTA-s, të hyjë në negociata që të përfshijë në zotimet e saj sipas PSH 6 trajtimin jo më pak të favorshëm se atë që i ofrohet shërbimeve dhe ofruesve të shërbimeve në kuadër të marrëveshjes ndërkombëtare përkatëse (Neni 3.2 PSH 6). Siç u cekë në Parathënien e PSH 6, marrëveshja bëhet "në përputhje me Nenin V të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë e Shërbimeve (GATS) të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT)", prandaj zotimet e bëra sipas saj nuk duhet të zgjerohen tek vendet tjera, madje as nga anëtarët e CEFTA-s, të cilat janë Anëtare të OBT-s. Duhet theksuar se PSH 6 nuk ka përfshirë klauzolën për të drejtat e fituara e cila gjendet në Nenin II.2 të GATS.⁹

Detyrimi i KMF zbatohet edhe për zotimet specifike të miratuara në kuadër të GATS-it nga Anëtarët e CEFTA-s, të cilët janë Anëtarë të OBT-s, pasi neni 3.2 i referohet zotimeve të miratuara "sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare ekzistuese ose të ardhshme me cilëndo palë", të cilat gjithsesi përfshijnë zotimet e miratuara nga vendet e CEFTA-s – Anëtare të OBT-s në përputhje me GATS-in. Nëse ndonjë zotim në GATS përfshin sektorët që nuk gjenden në PSH 6, dhe/ose ofrojnë trajtim të favorshëm përtej asaj që është cekur në PSH 6, Kosova do të kishte të drejtën të kërkojë hyrjen në negociata me palën përkatëse të CEFTA-s, të cilës do t'i jepet trajtimi më favorizues, i cili do të duhej të përfshihej në planin e anëtarit përkatës të CEFTA-s.

Ushtrimi që do të ishte i përshtatshëm në këtë drejtim do të ishte krahasimi i zotimeve specifike të anëtarëve të CEFTA-s së OBT-s sipas GATS me ato nga PSH 6, si dhe ofertat fillestare të paraqitura nga Anëtarët e CEFTA-s të OBT-s mbi negociatat aktuale në kuadër të Agjendës së Zhvillimit të Doha-s, si dhe shërbimet e ofruara të paraqitura nga Bosnja & Hercegovina dhe Serbia në kontekst të negociatave të tyre aktuale për t'u anëtarësuar në OBT.¹⁰ Mund të pritet, në bazë

⁹ Por sipas GATS-it, vendet anëtare mund t'i shmangen këtij standardi nëse Anëtarit ka renditur masat e tilla në "Shtojca në Nenin II Përfshirjet" dhe nëse janë plotësuar kushtet për përjashtime të tilla. Ky fleksibilitet u konsiderua i nevojshëm për të mbajtur rregulloret apo marrëveshjet ekzistuese që nuk janë në përputhje me detyrimin e KMF dhe për të ruajtur të drejtën e mundshme për të përdorur masa reciproke ose masa të njëanshme të liberalizimit. Pothuajse të gjitha vendet kanë kërkuar disa përjashtime të KMF në GATS në fushat si aviacioni civil dhe detar, telekomunikacioni dhe shërbimet financiare. Përjashtime të ngjashme janë kërkuar edhe për trajtimin kombëtar.

¹⁰ Vlerësimi i zotimeve të miratuara nga Anëtarët e CEFTA të OBT sipas GATS dhe ofertat fillestare në negociatat aktuale mund të gjenden në: ECORYS (2010). "Potencialet për Liberalizim të Tregtisë së Shërbimeve ndërmjet Palëve të CEFTA-s 2006: Identifikimi i mundësive, fitimeve dhe themeleve për negociata". Shkurt. Gjendet në web faqen e Sekretariatit të CEFTA-s.

të përvojave të vendeve të tjera që së fundi janë anëtarësuar në OBT, që B&H dhe Serbia të kërkohet të marrin zotime të zgjeruara për tregtinë e shërbimeve, të cilat mund të shkojnë përtej zotimeve të tyre në kuadër të PSH 6. Siç parashikohet me PSH 6, Kosova do të ketë të drejtën të kërkojë të hyjë në negociata për zgjerim të atyre zotimeve.

Përjashtimi i vetëm nga KMF i përfshirë në PSH 6 është trajtimi që i jepet ofruesve të shërbimeve të BE-s sipas MSA-s ose sipas marrëveshjes së Moldavisë me BE-n (Neni 3.3). Nevojitet një vlerësim i kujdesshëm i dispozitave në MSA-n aktuale që mund të kenë ndikim në tregtinë e shërbimeve për të bërë vlerësim gjithëpërfshirës të implikimeve reale të këtij përjashtimi në KMF. Mirëpo, në shikim të parë kjo do të nënkuptojë se shërbimet dhe ofruesit e shërbimeve të BE-s do të mund të pranojnë në parim trajtim më të favorshëm se ai që i është dhënë shërbimeve dhe ofruesve të shërbimeve të Anëtarëve të CEFTA-s. Kjo gjithashtu nënkupton se nëse në të ardhmen ndonjë nga anëtarët e CEFTA-s e negocion tregtinë e shërbimeve në kuadër të marrëveshjes me BE-n, trajtimi më i favorshëm që i jepet shërbimeve dhe ofruesve të shërbimeve të BE-s nuk zgjerohet automatikisht tek të gjithë anëtarët e CEFTA-s.

Një çështje që kërkon sqarim lidhur me KMF është shtrirja e fjalisë së fundit të Nenit 3.3, "*Trajtimi që u jepet shërbimeve dhe ofruesve të shërbimeve nga BE sipas legjislacionit vendor të cilën Pala e ka miratuar për qëllime të anëtarësimit të saj në BE përjashtohet nga detyrimet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2*". Çfarë nënkupton kjo saktësisht? A duhet ta kuptojmë që transpozimi i *acquis* të BE-s në çdo kohë bëhet me qëllim të anëtarësimit? Në këtë rast, nëse trajtimi KMF nuk zgjerohet tek palët tjera të CEFTA-s, ato do të trajtohen pafavorshëm në krahasim me palët e tjera. Pas anëtarësimit në BE, PSH 6 nuk do të vlejë më për atë anëtar të CEFTA-s, prandaj çdo legjislacion që e miraton atë nga ai moment do të ishte absolutisht i palogjikshëm për qëllime të Nenit 3.

3.2 Pezullimi

PSH 6 ka paraqitur një detyrim të rëndësishëm GATS *plus* me implikime të rëndësishme për politikën dhe rregulloren e ardhshme të tregtisë; atë të zotimit të *pezullimit* gjithëpërfshirës. Neni 4.3 parashikon që "*Asnjë Palë nuk vendos në territorin e saj kufizime të reja për ofrimin e shërbimeve, siç përcaktohet në Nenin 2 paragrafi 2, përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë Protokoll*". Prandaj, Kosova nuk do të mund të miratojë fare pas hyrjes në fuqi të PSH 6 ndonjë masë të re të llojit të përcaktuar në Nenin 4.2, që ndikon në çdo sektor të shërbimeve, si dhe në çdo mënyrë të ofrimit, siç parashikohet me përkufizimin e tregtisë së shërbimeve të përfshirë në protokoll.¹¹

Ky është një zotim mjaft i rreptë, pasi që Kosova do të mundet ta mbajë *status quo-n* vetëm në lidhje me listën e kufizimeve të qasjes në treg në çdo sektor dhe çdo mënyrë të ofrimit. Administrimi i ardhshëm i ofrimit në nivel të CEFTA-s do të mund të bëhet shumë problematik. Ndryshe nga rasti i marrëveshjeve të tjera për liberalizim të tregtisë së shërbimeve që kanë përfshirë detyrimin e *pezullimit*, PSH 6 nuk ka përfshirë listën e kufizimeve ekzistuese për qasje në treg për të gjithë anëtarët e CEFTA-s.¹² Prandaj, nuk ka informacione themelore mbi kufizimet aktuale për qasjen në treg që prekin sektorë të ndryshëm të shërbimeve dhe mënyra të ndryshme të furnizimit në të gjitha vendet e CEFTA-s. Për më tepër, detyrimet e transparencës të përfshira në Nenin 9 të PSH 6 janë mjaft të kufizuara sa i përket sektorëve të shërbimeve në të cilët nuk janë bërë zotime specifike nga Palët e CEFTA-s. Detyrimi i njoftimit (Neni 9.4) ka të bëjë vetëm me ata sektorë ku

¹¹ Ky detyrim është përfshirë nën Nenin për qasjen në treg. Prandaj duhet të kuptohet se ai ka të bëjë vetëm me listën e masave të përfshira në atë nen.

¹² Shih për shembull: Vendimi 439 i Komunitetit të Andeve. "Korniza e Përgjithshme e Parimeve dhe Rregullave për Liberalizim të Tregtisë së Shërbimeve në Komunitet"; e datës 11 qershor, 1998.

anëtari ka ndërmarrë zotime specifike. Monitorimi i zbatimit të Nenit 4.3 nga të gjitha Palët e CEFTA-s duhet të vendoset lartë në agjendën e Sekretariatit të CEFTA-s.

3.3 Transparenca

Neni 9 i PSH 6 përfshin dispozita të ngjashme të transparencës të cilat i kanë ato që gjenden në Nenin III të GATS, si dhe në rastin e shumicës së marrëveshjeve që liberalizojnë tregtinë e shërbimeve. Transparenca përbën detyrimin e rëndësishëm të përgjithshëm që Anëtarët e CEFTA-s duhet ta respektojnë lidhur me tregtinë e shërbimeve, sepse zbatohen të gjithë paragrafët përveç (Neni 9.4) pavarësisht nga zotimet specifike të bëra nga një anëtar, dmth. pa kushte. Dy zotimet kryesore rrjedhin nga dispozitat e transparencës në PSH 6 që mbulojnë të gjitha masat, sektorët dhe mënyrat e ofrimit: (a) detyrimi për të publikuar, ose ndryshe t'i bëjnë publike, të gjitha rregulloret dhe masat përkatëse për zbatim të përgjithshëm që prekin tregtinë e shërbimeve. Publikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare bën gjithashtu pjesë në fushëzbatimin e këtij detyrimi; (b) zotimi për të ofruar paraprakisht informata mbi çdo masë përkatëse për zbatim të përgjithshëm të cilën e propozon Pala për ta miratuar në mënyrë që t'u ofrojë Palëve të tjera mundësinë të komentojnë mbi masën. Ky zotim i fundit kërkon që anëtarëve të CEFTA-s t'u ofrohen informata mbi rregulloren e propozuar përmes Nën-Komitetit për Tregtinë e Shërbimeve (KTSH).

Transparenca e mëparshme (*ex-ante*), në formë të detyrimeve që parashikojnë konsultime me të gjitha palët e interesit para miratimit të një ligji apo rregulloreje të re, sigurisht që do të ketë pothuaj ngarkesë dhe kosto më të lartë administrative. Mirëpo, zbatimi i këtyre detyrimeve në Kosovë nuk do të nënkuptojë përpjekje të rëndësishme shtesë administrative ose amendamente legjislative. Janë publikuar të gjitha masat e zbatimit të përgjithshëm (Ligjet, Udhëzimet Administrative dhe të tjera) dhe konsultimet publike tashmë janë përfshirë në procesin e zakonshëm legjislativ. Rregullorja e vitit 2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik sqaron standardet, parimet dhe procedurat për konsultime gjatë hartimit të legjislacionit. Kosova do të duhet të krijojë një mekanizëm që do të sigurojë ofrim të shpejtë dhe efikas të informatave mbi ndryshimet e propozuara në rregulloret ekzistuese ose çdo rregulloreje të re dhe të mundësojë lehtësimin e pjesëmarrjes së akterëve të huaj të interesuar në konsultime të hapura publike.

Detyrimi që rrjedh nga Neni 9.3 është themelimi i Pikës së Kontaktit për Shërbime (PKSH), siç parashikohet nga CEFTA (2006) Neni 44.¹³ As Neni 44 i CEFTA-s dhe as Neni 9.3 i PSH 6 nuk parashikojnë ndonjë udhëzues për natyrën e një pike të tillë kontakti, dhe as afatin kohor për zbatimin e saj. Detyrimi që imponohet është "*qasja në informata*", ashtu që kërkohet nga çdo Anëtar t'i përgjigjet shpejtë çdo kërkesë të një Anëtari tjetër që ka të bëjë me masat që hyjnë në fushën e PSH 6. Ky detyrim është paksa i kufizuar sepse Neni 44 i CEFTA-s lejon vetëm pikët e kontaktit ndërmjet qeverive. Palët tjera të interesit, siç janë ofruesit e shërbimeve individuale nuk do të kishin të drejtën të shfrytëzojnë PKSH-n për të kërkuar informata mbi masat që prekin tregtinë e shërbimeve.¹⁴

Anëtarët e CEFTA-s, që janë Anëtarë të OBT-s tashmë kanë krijuar "qendrat informative" siç është paraparë në Nenin III të GATS. Kërkesat për informata nga Anëtarët e tjerë përmes qendrave informative mund të lidhen me: (a) masat e zbatimit të përgjithshëm që ndikojnë në funksionimin e GATS-it; (b) marrëveshjet ndërkombëtare në të cilën merr pjesë një Anëtar i caktuar; ose (c) masat që janë subjekt i njoftimit në përputhje me Nenin III:3 të GATS, kjo ka të bëjë me ndryshimet

¹³ Neni 44 i CEFTA-s thotë se "Çdo Palë u përgjigjet menjëherë të gjitha kërkesave të bëra nga një Palë tjetër për informacion të veçantë në lidhje me çdo masë të tyre me zbatim të përgjithshëm ose marrëveshje ndërkombëtare që i takojnë ose ndikojnë në këtë Marrëveshje. Palët vendosin një pikë kontakti tek e cila paraqiten këto kërkesa. Pikat e kontaktit ua kalojnë menjëherë këto kërkesa agjencive të brendshme përkatëse."

¹⁴ Në GATS përveç qendrave informative, anëtarët e vendeve të zhvilluara duhet të themelojnë "Pikat e Kontaktit" ku ofruesit e shërbimeve të vendeve në zhvillim mund të kërkojnë drejtpërdrejtë informacione.

ose rregulloren e re për sektorë, e përfshirë në zotimet specifike të anëtarëve, e cila është ekuivalente me detyrimin në Nenin 9.3 të PSH 6. Derisa qendrat informative pritet të ofrojnë informata, ato duhet të jenë deponuese të ligjeve dhe rregulloreve vendore (Neni III:4, fjalia 5 i GATS). Detyrimet që dalin nga PSH 6 në këtë drejtim, paraqesin detyrimet e transparencës të GATS. Në rastin e GATS-it, është miratuar një format i veçantë për njoftimet e nevojshme. Këto udhëzime mund të ofrojnë bazën për zhvillim të ngjashëm në kuadër të PSH 6.¹⁵

Kosova do të duhet të krijojë PVK-n e vet për të përmbushur detyrimet e transparencës. Siç e parashikon Ligji për Shërbime, ajo njëherit duhet të krijojë në të ardhmen Pikën e Vetme të Kontaktit (PVK). Këto dy mekanizma janë mjaft të ndryshëm në fushëveprim dhe në funksionim. Së pari, PVK-ja është vend për shkëmbim të informatave ndërmjet qeverive të vendeve të CEFTA-s, pa qasje të drejtpërdrejtë për operatorët e shërbimeve. Përkundrazi, PVK-ja është kryesisht i orientuar në operatorët e shërbimeve në sektorin privat. PKSH-ja ka shtrirje më të gjerë se PVK-ja. E para mbulon të gjithë sektorët e shërbimeve nën PSH 6, ndërsa PKSH-ja vetëm ata sektorë që përfshihen në Ligjin për Shërbime. Në Ligjin për Shërbime ka përjashtime të rëndësishme sektoriale. Në fund, funksioni i vetëm i PKSH-s është të ofrojë informata sipas kërkesës për çështjet e përfshira në PSH 6; ndërsa PVK-ja duhet gjithashtu t'u mundësojë operatorëve të shërbimeve qasjen elektronike në të gjitha proceset që nevojiten për të hyrë në treg. PVK-t janë portale të qeverisë-e të cilat ofrojnë informata mbi kërkesat administrative dhe qasjen në procedurat elektronike për të përfunduar formalitetet e nevojshme në internet.

Edhe pse ka dallime ndërmjet PKSH-s dhe PVK-s, nuk do të jetë e logjikshme të kishte marrëveshje të ndryshme institucionale për të përmbushur funksione të ndryshme. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) do të jetë përgjegjëse për PVK-n në Kosovë dhe ajo duhet të jetë përgjegjëse edhe për PKSH-n. Tashmë është filluar të punohet që gradualisht të realizohet PKSH-ja si hap i parë në krijimin e një PVK-je të zhvilluar plotësisht në vend.¹⁶ Mirëpo, krijimi dhe funksionimi efektiv i PVK-s do të kërkojë përpjekje të konsiderueshme të bëra nga disa subjekte të ndryshme publike. Është treguar se krijimi i PVK-s në BE është një përpjekje mjaft komplekse.¹⁷

3.4 Njohja

Neni 11 i PSH 6 përfshin disa detyrime të përgjithshme për njohjen e arsimimit apo përvojës së fituar, kërkesat e përmbushura ose licencat ose certifikatat që u janë dhënë një ofruesi të shërbimit të një vendi tjetër të CEFTA-s. Detyrimi për njohje vlen pavarësisht nëse vendi ka bërë ose jo zotime specifike për sektorin e shërbimeve përkatëse.

Siç e parashikon neni i cekur, Kosova do të duhet t'i jep "konsideratë të duhur" çdo kërkesë nga Pala tjetër e CEFTA-s për të njohur arsimimin apo përvojën e fituar, kërkesat e përmbushura, ose licencat ose certifikatat që i janë dhënë asaj Pale tjetër. Kjo është klauzolë e butë e traktatit, pasi kuptimi për t'i dhënë konsideratë të duhur mund të hapë një sërë interpretimesh. Nuk ka jurisprudencë të GATS-it që do të mundësonte shqyrtimin e fushëveprimit dhe implikimeve të këtij detyrimi të përgjithshëm lidhur me ofruesit e shërbimeve i cili kërkon licencë ose leje për të vepruar në treg.

Përveç kësaj, Paragrafi 3 përfshin një trajtim të menjëhershëm dhe të pakushtëzueshëm të KMF midis vendeve të CEFTA-s në lidhje me zbatimin e standardeve ose kritereve të tij për autorizim, licencim ose certifikim të ofruesve të shërbimit. Ky detyrim eliminon çdo mundësi që Kosova të

¹⁵ OBT. Udhëzimet për Njoftime Sipas Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë e Shërbimeve, S/L/5, 4 prill 1995.

¹⁶ MTI-ja ka krijuar një udhërrëfyes për krijimin e PVK-s dhe është përfshirë në përmirësimin e Bazës së të Dhënave për Shërbime të MTI. Referojuni MTI-s (2018) Plan-Vepri për PVK, Dhjetor.

¹⁷ Caggemini Consulting and Eurochambers (2015). "Efektshmëria e Pikave të Vetme të Kontaktit: Vlerësimi i Kartës së PVK". Drejtori Gjeneral për tregun e Brendshëm i BE, qershor.

ofrojë trajtim të ndryshëm në bazë të vendit të CEFTA-s ose origjinës së shërbimit ose kombësisë së ofruesit të shërbimit në të ardhmen. Ne nuk kemi identifikuar ndonjë masë në fuqi që mundet drejtpërdrejtë të diskriminojë shërbimet dhe ofruesit e shërbimeve të CEFTA-s. Por diskriminimi mund të lindë edhe nga mënyra në të cilën zbatohet rregullorja, prandaj kjo është një çështje që duhet të monitorohet në të ardhmen.

Një detyrim më konkret rrjedhë nga Neni 11.2, me të cilin Kosova nëse me marrëveshje apo ndonjë lloj tjetër ujdije, apo njuh në mënyrë autonome arsimin dhe përvojën e fituar, kërkesat e përmbushura, apo licencat apo certifikatat e marra, në territorin e një pale tjetër që nuk është në CEFTA, pas hyrjes në fuqi të PSH 6, duhet t'i ofrojë mundësinë e duhur çdo anëtar tjetër të CEFTA-s për të negociuar mbi qasjen në marrëveshje apo ujdije, apo në rastin e njohjes autonome të demonostrojë se ofruesit e shërbimeve të saj i përmbushin kërkesat e njëjta dhe për këtë arsye ato duhet të njihen nga autoritetet përkatëse të Kosovës.

Është interesante të ceket se PSH 6 nuk e ka përfshirë kërkesën për transparencë dhe njoftim sipas Nenit VII (a)(b)(c) të GATS.¹⁸ Ky është lëshim i rëndësishëm pasi nuk do të ketë inventarizim të marrëveshjeve apo ujdive të njohjes, apo masave për njohje autonome dhe nuk ka detyrim të njoftimit mbi zhvillime të reja në këtë fushë që do t'u mundësonte anëtarëve të tjerë të CEFTA-s të aktivizojnë dispozitat e Nenit 11.2. Vendet e CEFTA-s Anëtare apo vëzhguesë të OBT-s do të kenë qasje në informata përmes procesit të njoftimit të OBT-s. Barra do t'i mbetet Kosovës të gjejë mënyrën për qasje në informata të nevojshme, të cilat mundësojnë identifikimin e marrëveshjeve, ujdive apo njohjen autonome në fuqi tek Anëtarët e tjerë të CEFTA-s.

Në lidhje me Nenin 11.2, do të duhet të bëhet një shqyrtim nëse Kosova ka ndonjë marrëveshje apo ujdije që çon në njohje dhe nëse ajo ka njohur në mënyrë autonome shërbimet dhe ofruesit e shërbimeve të cilat do shtet. Qëllimi i një analize të tillë shkon përtej qëllimit të këtij dokumenti, por ajo duhet të bëhet për të pasur një perspektivë më të qartë të implikimeve të mundshme në të ardhmen të detyrimeve të njohjes të PSH 6. Mirëpo, duhet vërejtur drejtë se detyrimi është vetëm t'i ofrohet mundësia palës tjetër për të negociuar një marrëveshje të ngjashme apo për t'iu qasur njohjes autonome. Nuk ka asgjë në PSH 6 që e presupozon rezultatin e negociatave apo kërkesën për njohje autonome. Për aq sa jemi në dijeni, dispozitat e ngjashme që gjenden në GATS ende nuk janë aktivizuar nga ndonjë Anëtar i OBT-s dhe nuk ka pasur ndonjë proces të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që do të bazoheshin në shkelje të Nenit VII përkatës të GAT-it.

3.5 Monopolet dhe Ofruesit Ekskluziv të Shërbimeve

PSH 6 ka përfshirë, përmes Nenit 12, dispozitat që rregullojnë sjelljen e monopolit apo ofruesve ekskluziv të shërbimeve, të cilat përfshijnë edhe situatat ku një anëtar i CEFTA-s formalisht ose në fuqi, (a) autorizon ose formon një grup të vogël të ofruesve të shërbimeve dhe (b) kryesisht ndalon konkurrencën midis atyre ofruesve në territorin e vet. Këto dispozita saktësisht transpozojnë ato të GATS-it për këto çështje. PSH 6 nuk ndalon monopolet apo ofruesit ekskluziv të shërbimeve. Detyrimi që buron nga themeli është se në këto situata, për aq sa ato mund të ekzistojnë në Kosovë, autoriteti do të duhet të sigurojë që ofruesit e shërbimeve të respektojnë plotësisht parimin e KMF-s në ndërmarrjet e tyre tregtare.¹⁹ Aktualisht në Kosovë nuk ka monopole

¹⁸ Sipas Nenit VII 4 të GATS. Çdo Anëtar: (a) njofton brenda 12 muajve nga data në të cilën Marrëveshja e OBT-s ka hyrë në Këshillin për Tregtinë e Shërbimeve mbi masat e tij ekzistuese të njohjes dhe të deklarorë nëse ato masa bazohen në marrëveshjet apo ujdite e llojit nga paragrafi 1; (b) menjëherë njofton Këshillin për Tregtinë e Shërbimeve sa më parë të jetë e mundur për hapjen e negociatave për një marrëveshje apo ujdije të llojit nga paragrafi 1 në mënyrë që t'i ofrojë çdo Anëtar tjetër mundësinë të cekë interesat e tij për të marrë pjesë në negociata para se të hyjë në fazë konkrete; (c) menjëherë njofton Këshillin për Tregtinë e Shërbimeve kur i miraton masat e njohjes ose i ndryshon ato ekzistuese në masë të konsiderueshme dhe deklarorë nëse masat bazohen në marrëveshje apo ujdije të llojit nga paragrafi 1.

¹⁹ Qëllimi i dispozitës është i kufizuar në ofrimin e shërbimit të monopoleve dhe për këtë arsye nuk janë përfshirë blerjet e monopolistëve, qoftë nëse ato janë për input ose konsum të tyre.

apo ofruet ekskluziv të shërbimeve të sanksionuara nga shteti. Për ta plotësuar analizën, duhet të shqyrtohet më tej gjendja ku në çdo sektor janë të autorizuar vetëm disa ofruet të shërbimeve në Kosovë. Kjo gjendje do të mund të paraqitet *de facto*, edhe nëse jo *de jure*, kur nevojitet një test i nevojës ekonomike (TNE) për autorizim të ofruesve të shërbimeve.

Përveç kësaj, nëse Kosova ka bërë zotime specifike në sektor, ajo do të duhet të garantojë se monopoli ose ofruesi ekskluziv nuk vepron në kundërshtim me zotimet specifike të ndërmarra në lidhje me sektorin përkatës.²⁰ Në këtë drejtim, për shembull, Kosova ka bërë liberalizimin e plotë të shërbimeve postare dhe ekzistojnë disa çështje lidhur me kushtet nën të cilat ajo ofron disa nga ato shërbime. Kjo është një çështje e cila duhet të merrë vëmendje të menjëhershme para se PSH 6 të hyjë në fuqi për t'i ikur ndonjë shkelje të pavullnetshme të zotimeve të përvetësuara.

3.6 Konkurrenca

PSH 6 nuk ka disiplina për konkurrencën si të tillë. Neni 13, edhe pse pranon se praktikat e caktuara të bizneseve të ofruesve të shërbimeve mund të frenojnë konkurrencën dhe me këtë kufizojnë tregtinë e shërbimeve, përfshin vetëm detyrimin e anëtarëve të CEFTA-s që të pranojnë konsultime me kërkesë të një anëtari tjetër për të trajtuar çdo praktikë biznesi që mund të kufizojë konkurrencën dhe të kufizojë tregtinë e shërbimeve. Kjo dispozitë përmban vetëm detyrime të kufizuara konkrete: detyra për t'u konsultuar, mirëbesimi në ato konsultime dhe ofrimi i informatave (përfshirë mbrojtja e konfidencialitetit). Mekanizmi konkret për të adresuar situatat e tilla dhe funksionimin e tij do të duhej të krijohet nga Anëtarët e CEFTA-s, si dhe për të adresuar çështjen se cilat do të ishin pasojat nëse konsultimet nuk u ofrojnë palëve një zgjidhje të kënaqshme. Nuk ka rregulla të konkurrencës në kuadër të CEFTA-s, të cilat do të mund të zbatoheshin në këto raste; Konkurrenca në regjion rregullohet me legjislacionin kombëtar.

Shqetësimi për çështjet e konkurrencës në tregtinë e shërbimeve po rritet gjithnjë e më shumë në mbarë botën, në veçanti për rritjen e tregtisë digjitale të shërbimeve dhe për disa sektorë, *né mes tjerash*, transportin detar dhe turizmin, dhe shërbime të tjera ku po bëhet përqendrim i konsiderueshëm i bizneseve në nivel regjional dhe global. Do të ishte interesant nëse bëhen përpjekje në nivel të CEFTA-s të vlerësohet problem i konkurrencës në tregtinë e shërbimeve brenda CEFTA-s dhe të shikohet zhvillimi i disa disiplinave regjionale për të trajtuar problemet më të rëndësishme potenciale.

3.7 Tregtia Elektronike

Neni 18.3 i PSH 6 përfshin detyrimin e përgjithshëm lidhur me tregtinë-e. Ai thotë se "*Palët pajtohen se dërgimi me mjete elektronike konsiderohet ofrim i shërbimeve, në kuptimin e Nenit 2 paragrafi 2(a), dhe nuk i nënshtrohet detyrimeve doganore*". Kjo është dispozita *plus* e GATS-it, pasi nuk ka asnjë detyrim të ngjashëm në të.

PSH 6 e ka shndërruar moratoriumin e përkohshëm të miratuar në OBT në detyrim të përhershëm, i cili obligon të gjitha vendet anëtare të CEFTA-s. Në vitin 1998 Anëtarët e OBT-s kanë miratuar një Deklaratë për Tregtinë Elektronike, e cila përfshinte një moratorium dyvjeçar për detyrimet doganore në transmetimet elektronike. Që atëherë, me përjashtim të viteve 2002-2003, moratoriumi është zgjeruar çdo dy vjet. Çështje tjetër e rëndësishme që duhet të theksohet në lidhje me detyrimin është se ai ka përcaktuar të gjitha dërgesat me mjete elektronike si ofrim i një shërbimi, çështje e cila është akoma temë diskutimi në kuadër të sistemit multilateral të tregtimit.

²⁰ Kjo gjithashtu përfshin situatën "Ku ofruesi i monopolit të të njëjtit konkurrenca drejtpërdrejtë ose përmes një kompanie të bashkuar, në ofrim të shërbimit jashtë fushëveprimit të të drejtave të monopolit të tij dhe që i nënshtrohet zotimeve specifike të asaj Pale, Pala siguron që ofruesi i tillë nuk e keqpërdor pozitën e tij në monopol për të vepruar në territorin e saj në mënyrë të papajtueshme me zotimet e tilla". (Neni 12.2 PSH 6)

Koncepti “dërgimi me mjete elektronike” që përdoret në PSH 6 është shumë më i gjerë se “tregtia në produktet e digjitalizuara” e cila do të ishte shumë më afër tregtisë ndërkufitare të shërbimeve përmes Modalitetit 1. Tregtia ndërkufitare e shërbimeve përmes teknologjive të informacionit dhe komunikimit paraqet disa sfida përfshirë fuqizimin, kontrollin dhe përgjegjshmërinë. Ende nuk ishte e mundur deri me sot që në kuadër të GATS-it të eliminohen paqartësitë interpretuese të disa nga dispozitat e saj, të shkaktuara nga mundësia për të ofruar një numër të larmishëm dhe në rritje të shërbimeve tradicionale dhe të reja nga distanca me mjete elektronike. Në këtë drejtim për shembull është posaçërisht e vështirë të bëhet dallimi midis ofrimit ndërkufitar dhe konsumit jashtë vendit në rastin e tregtisë-e. Debatet e ndezura në kontekst të Programit të Punës për Tregtinë-e (PPET) të OBT-s duket se janë nxitur pjesërisht nga mosgatishmëria politike e Anëtarëve të pranojnë se detyrimet e tyre ndaj OBT-s zbatohen në këtë fushë të re të tregtisë së shërbimeve ndërkombëtare.

Një çështje që duhet të theksohet është se PSH 6 nuk përfshin përkufizimin e “tregtisë elektronike” për të cilën duhet të zbatohet detyrimi. Në këtë drejtim, nuk ka përkufizim të dakorduar ndërkombëtarisht për tregtinë-e dhe kjo është njëra nga fushat që po shtjellohet në kontekst të programit të punës të OBT-s, edhe pas 20 vjetësh.²¹ Tregtia-e, e përkufizuar shumë gjerësisht, do të mund të përfshijë të gjitha transaksionet e vlerës, ku përfshihet bartja e informatave, produkteve, shërbimeve ose pagesave përmes rrjeteve elektronike. Kjo do të përfshijë përdorimin e komunikimit elektronik si medium përmes të cilit dizajnohen, prodhohen, reklamohen, katalogohen, regjistrohen, blihen ose dorëzohen mallrat dhe shërbimet. Në Programin e Punës të OBT-s për Tregtinë Elektronike, është vendosur që: *"Vetëm për qëllime të programit të punës dhe pa e vënë në pyetje rezultatin e tij, me termin 'tregti elektronike' nënkuptohet prodhimi, shpërndarja, marketingu, shitja ose dorëzimi i mallrave dhe shërbimeve me mjete elektronike"*. Prandaj, në fushën e tregtisë, tregtia elektronike mund të kuptohet se përfshin tri lloje të ndryshme të transaksionit, dhe që të gjitha duhet shqyrtuar: (a) ofrimi i vet shërbimeve për qasje në internet – që nënkupton ofrimin e qasjes në rrjet për biznese dhe konsumatorë; (b) ofrimi elektronik i shërbimeve, që nënkupton transaksionet ku produktet e shërbimeve u ofrohen konsumatorëve në formë të qarkullimit të informatave të digjitalizuara; (c) përdorimi i internetit si kanal për shërbime të distribuimit, me anë të të cilit blihen mallrat dhe shërbimet në rrjet, por u dorëzohen konsumatorit më pas në formë jo-elektronike.

Në OBT, si dhe në qarqet akademike, vazhdon debati nëse disa produkte, të cilat mund të dorëzohen si një bartës fizik, ashtu edhe në formë thjesht elektronike (në mes tjerash softueri kompjuterik, muzika, materialet e shtypura/librat-e, filmat dhe video lojrat), duhet të klasifikohen më së miri si shërbime apo mallra. Klasifikimi i transaksioneve të tilla përcakton nëse zbatohet GATT-i apo GATS-i, me implikime potencialisht të rëndësishme për detyrimet ligjore të Anëtarëve të OBT-s. Në sistemin e OBT-s, regjimi ligjor i cili rregullon një transaksion të caktuar përcaktohet përnanga natyra e produktit që tregtohet, e jo përnanga procesi i prodhimit ose mënyra e dorëzimit. Për këtë arsye, po të kishte marrëveshje që disa kategori të produkteve të cilat dorëzohen në mënyrë elektronike duhet të klasifikohen dhe trajtohen si mallra, importimi i tyre do t'i nënshtrohej çfarëdo detyrimi tarifor dhe të gjitha detyrimeve të tjera të zbatueshme të GATT.

Në Konferencën Ministrore të OBT-s në Buenos Aires në dhjetor të vitit 2017, Anëtarët e OBT-s ripohuan zotimin e tyre për të vazhduar programin e punës për tregtinë elektronike; ndërsa një numër i konsiderueshëm i Anëtarëve të OBT-s shprehën nivel më të lartë të ambicies dhe qëllimit dhe nxorrën një Deklaratë të Përbashkët, e cila njofton mbi iniciimin e “punës kërkimore drejt

²¹ OBT (1998): Programi i Punës për Tregtinë Elektronike të 30 Shtatorit 1998. Dok. i OBT WT/L/274, 1. Ndër çështjet që shtjellohen në Programin e Punës të OBT-s për Tregtinë Elektronike, ne kemi në mes tjerash si vijon: fushëveprimi dhe përkufizimi i transmetimeve elektronike; implikimet e moratoriumit në të ardhura; realizueshmëria teknike e vendosjes së detyrimeve doganore; dhe ndikimi më i gjerë i moratoriumit në tregti dhe industrializim.

negociatave të ardhshme të OBT-s për aspektet tregtare të tregtisë-e”. Në këtë fushë, PSH 6 ka bërë një hap më tej, duke përfshirë përkufizimin e fushëveprimit të tregtisë-e dhe duke miratuar një detyrim të përhershëm; ndërsa në OBT, Anëtarët ende nuk kanë arritur konsensusin se si të përfshijnë çështjet e tregtisë-e në marrëveshjet ekzistuese të OBT-s.

IV. Detyrimet e përgjithshme për shërbimet e planifikuara

PSH 6 paraqet tre detyrime të përgjithshme kryesore në lidhje me sektorët ku zotimet specifike, qoftë për qasjen në treg ose trajtimin kombëtar, janë miratuar nga një anëtar: për transparencë, rregullim vendor dhe për pagesat dhe transferet.

4.1 Transparenca

Neni 9.4 të PSH 6 prezanton, siç është edhe rasti në GATS, një detyrim të veçantë të transparencës që vlen për zotimet specifike të përvetësuar. Pas hyrjes në fuqi të protokollit, Kosova është e detyruar ta njoftojë, menjëherë dhe të paktën çdo vit, Nën-komisionin e CEFTA-s për Tregtinë e Shërbimeve për përfshirjen e ndonjë ndryshimi të ri apo çdo ndryshimi në ligjet, rregulloret apo udhëzuesit ekzistues administrativ, të cilët ndikojnë në tregtinë e shërbimeve të përfshira në zotimet e saj specifike. Kjo nënkupton njoftimin të masave pasuese (*ex-post*) që janë miratuar. Protokollin është i heshtur në lidhje me specifikat e informatave që duhet të ofrohen në këto raste, por ai sigurisht që do të nënkuptojë njoftimin e plotë mbi masat e miratuara. Këtë funksion të njoftimit duhet ta kryejë Pika e Kontaktit të Shërbimeve (PKSH); e cila siç është vendosur do të gjendet në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI). Duhet menjëherë të krijohet një mekanizëm i cili siguron qarkullim të duhur të informatave ndërmjet subjekteve të ndryshme që i përkushtohet aktiviteteve të ndryshme të shërbimeve dhe duhet të ndahen burime të nevojshme fizike dhe njerëzore.

4.2 Rregullimi i brendshëm

Neni 10 i PSH 6 ka transpozuar drejtpërdrejtë Nenin VI të GATS-it, për rregullim të brendshëm, i cili është kthyer në një nga dispozitat më kontroverze për shkak të ndikimit të mundshëm në autonominë rregullatore të anëtarëve të OBT-s, dhe për shkak të marrëdhënies së pazgjidhur midis zotimeve të miratuara për qasjen në treg dhe rregullimin e brendshëm.²² Neni 10 i PSH 6 shton disiplina të tjera për rregullimin e brendshëm, të cilat përmbajnë kryesisht detyrime të një natyre procedurale. Nuk ka përkufizim të "rregullimeve të brendshme" të përfshira në dispozitat që i rregullojnë ato; por duhet kuptuar se ai përfshin të gjitha masat e përcaktuara nga PSH 6 që ndikojnë në shërbime, përveç atyre të radhitura në mënyrë të qartë në Nenin 4, dhe ato që diskriminojnë (qoftë de jure ose de facto) shërbimet e huaja ose ofruesit e huaj të shërbimeve dhe për këtë nuk janë përfshirë në Nenin 5 të PSH 6. Për më tepër, masat e tilla janë të një natyre cilësore, sepse ato zakonisht ndjekin objektivat legjitime të politikave, si për shembull sigurimin e cilësisë së shërbimit të ofruar dhe në këtë mënyrë të mos hyjnë në gjashtë kategoritë e kufizimeve të paraqitura në Nenin 4 të PSH 6 për kufizimet e qasjes në treg.

Derisa Neni 10 i PSH 6 mbron të drejtën e anëtarëve të CEFTA-s për të rregulluar dhe miratuar rregulloren e re në ndjekjen e objektivave legjitime të politikave, ai merret me mënyrën e administrimit të rregullimit të brendshëm dhe vendosjen e disa procedurave institucionale, përfshin disiplinat për kualifikim, standardet teknike dhe kërkesat për licencim, dhe përfshin një detyrim të

²² Muller, Gilles (2017). "Marrëdhënia e Trazuar nën ATS: Tensione midis Qasjes në Treg (Neni XVI), Trajtimi Kombëtar (Neni XVII) dhe Rregullimi i Brendshëm (Article VI)". *World Trade Review*, Volume 6, Issue 3. July.

rëndësishëm të natyrës tranzicionale për t'u përpjekur të zhvillojë elementet kryesore të disiplinave të ardhshme që e rregullojnë këtë fushë.²³

Dispozita në Nenin 10.2 obligon Anëtarët e CEFTA-s të sigurojnë se të gjitha *masat e zbatimit të përgjithshëm* që ndikojnë në tregtinë e shërbimeve të administrohen në mënyrë të arsyeshme, objektive dhe të paanshme.²⁴ Është e rëndësishme të theksohet se ai nuk rregullon përmbajtjen e masës por vetëm mënyrën në të cilën ajo administrohet. Ky detyrim mund të shikohet si një detyrim i qëndrueshmërisë dhe parashikueshmërisë për administrimin e kësaj mase ose ai që ndalon vendime diskriminuese ose arbitrare nga autoriteti përgjegjës. Në këtë kontekst, objektiviteti nënkupton që ligjet të zbatohen në mënyrë të drejtë, konsistente dhe të parashikueshme; sa i përket arsyeshmërisë, jurisprudencë e OBT-s vëren se praktikrat që nuk janë 'në përputhje me arsyen', 'nuk kanë gjykim të shëndoshë', 'nuk janë të arsyeshme', 'artikuluese' ose 'brenda kufijve të arsyes' konsiderohen të paarsyeshme; dhe kushti i paanshësisë nënkupton se nuk mund t'i jepet konsideratë e veçantë apo trajtim i privilegjuar njëres pale e tjetres jo.²⁵ Ky detyrim përpiket të sigurojë që ofruesit e huaj të shërbimeve të mos përballen me barrierat e panevojshme në tregti nga zbatimi i paqëndrueshëm, i njëanshëm ose arbitrar i rregullimit të brendshëm nga Anëtarët e CEFTA-s të cilat kanë ndërmarrë zotime specifike. Prandaj, një masë rregullatore, edhe nëse ndjekë një objektiv legjitim të politikës, mund të bëjë shkelje të PSH 6 nëse administrimi i saj është në kundërshtim me kërkesat nga Neni 10.2. Kjo është një çështje e cila duhet të monitorohet me kujdes për të garantuar se të gjitha autoritetet që administrojnë rregullimin e shërbimeve në Kosovë respektojnë obligimet detyruese të cilat vendi i ka përvetësuar në mënyrë të pavarur në një marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 10.3 më tej përfshin detyrimin për të mbajtur ose krijuar një mekanizëm institucional, qoftë gjykata ose procedura juridike, arbitrare ose administrative, që duhet të ofrojnë, me kërkesë të një ofruesi të prekur të shërbimeve "*shqyrtim të menjëhershëm, dhe kur arsyetohet, mjete të duhura juridike për vendime administrative që prekin tregtinë e shërbimeve*". Kushti kryesor i preferuar është që shqyrtimin ta bëjë një subjekt i pavarur i agjencisë së cilës i është besuar vendimi përkatës administrativ. Mirëpo, nëse nuk është ashtu, anëtarët e CEFTA-s gjithsesi duhet të sigurojnë se procedurat e krijuara në fakt mundësojnë një shqyrtim objektiv dhe të paanshëm. Nuk ka asnjë detyrim për të krijuar gjykata ose procedura që do të ishin të paqëndrueshme me strukturën kushtetuese të Anëtarit të CEFTA-s apo natyrën e sistemit të tij juridik; por animi nga shqyrtimi i paanshëm i vendimeve administrative dhe mjeteve juridike nëse ky është rasti, duhet të garantohet nga të gjithë anëtarët e CEFTA-s.²⁶ Qasja në procedura të paanshme për shqyrtim të vendimeve administrative është çështje e cila kërkon një vlerësim të kujdesshëm në rastin e subjekteve të

²³ Nuk ka udhëzime rreth asaj se çfarë duhet të kuptohet si "objektiva legjitim të politikave". Kjo është çështje e cila ka marrë vend të rëndësishëm në negociatat e vazhdueshme për rregullimin e brendshëm sipas GATS në Grupin Punues për Rregullimin e Brendshëm (GPRRB).

²⁴ Termi "masat për zbatimin e përgjithshëm" nuk është përkufizuar në GATS dhe nuk ka raste të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ku ky koncept është sqaruar. Mirëpo, është vërejtur se ne mund t'i kuptojmë si masa për zbatim të përgjithshëm ato që nuk kufizohen në zbatimin e një rasti të veçantë të caktuar ose të operatorit ekonomik. Ligjet, rregulloret, vendimet juridike dhe vendimet administrative për zbatimin e përgjithshëm mund të kuptohen si masa për zbatim të përgjithshëm, të cilat zbatohen për një sërë situata ose një numër të pidentifikuar të operatorëve ekonomik ose rasteve, por nuk kufizohen në fushëzbatimin e tyre. Masat për zbatimin e përgjithshëm mund të zgjerohen në aktvendime administrative në rastet e veçanta, ku aktvendimet e tilla vendosin ose rishikojnë parimet ose kriteret e zbatueshme në rastet e ardhshme.

²⁵ Krajewski M, 'Article VI GATS' in Wolfrum R, Stoll P-T and Feinäugle C (eds), Max Planck Kommentare mbi Ligjin e Tregtisë Botërore: OBT – Tregtia e Shërbimeve, vëll 6 (Martinus Nijhoff 2008)

²⁶ Neni 10.3(b) i PSH 6

ndryshme me attribute rregullatore në Kosovë. Vlerësimi duhet të përfshijë jo vetëm aspektet ligjore, por edhe zbatimin praktik të procedurave të shqyrtimit që janë në fuqi.

Në ato raste kur nevojitet autorizimi për të ofruar një shërbim, autoritetet kompetente të Kosovës duhet, brenda një periudhe të arsyeshme kohore pas parashtrimit të kërkesës së plotë, të njoftojnë parashtruesin e kërkesës mbi vendimin në lidhje me kërkesën. Autoritetet kompetente, me kërkesë të parashtruesit të kërkesës, duhet të ofrojnë informata lidhur me statusin e kërkesës pa vonesa të panevojshme (Neni 10.4).

Një detyrim i rëndësishëm lidhur me sektorët në të cilët Kosova ka përvetësuar zotime specifike janë kushtet që duhet të plotësohen gjatë miratimit dhe zbatimit të masave për rregullimin e brendshëm në lidhje me *kërkesat për kualifikim dhe licencim dhe standardet teknike*. Këto kategori përfshijnë një game të gjerë të rregullimeve të brendshme. Kërkesat për kualifikim përfshijnë kërkesat thelbësore të cilat një ofrues i shërbimeve duhet t'i plotësojë që të mund të marr certifikimin ose licencën, ndër të tjera një ekzaminim, dëshmi përvoja ose kërkesa gjuhësore. Procedurat e kualifikimit janë rregulla administrative për administrimin e kërkesave të kualifikimit, siç është natyra dhe numri i dokumenteve që duhet të dorëzohen ose tarifat që duhet të paguhen. Kërkesat për licencim përfshijnë të gjitha kërkesat mbështetëse që nuk hyjnë në kategorinë e kërkesave për kualifikim, të cilat do t'i mundësonin një ofruesi të shërbimeve të marrë autorizimin për të ofruar shërbim, siç është kërkesa për regjistrim ose themelim, garanci financiare ose anëtarësim në një organ profesional. Procedurat e licencimit janë procedura administrative që merren me parashtrimin dhe përpunimin e kërkesës për licencë. Në fund, standardet teknike përfshijnë kërkesat që mund të lidhen me karakteristikat e vet shërbimit, si dhe mënyrën në të cilin shërbimi kryhet.

Neni 10.5 i PSH 6 kërkon që rregullimi i brendshëm i cili merret me kërkesat për licencim dhe kualifikim dhe standarde teknike duhet: (a) të bazohet në kritere objektive dhe transparente, siç është kompetenca dhe aftësia për të ofruar shërbimin; (b) të mos paraqet më shumë ngarkesë se që duhet për të siguruar cilësinë e shërbimit; (c) në rastin e procedurave të licencimit, që në vetvete nuk paraqesin kufizim në ofrimin e një shërbimi; dhe, (d) që logjikisht nuk do të mund të priteshin në kohën kur Kosova ka bërë zotime specifike në ata sektorë. Prandaj, rregullimi vendor në këto fusha të cilat shfuqizojnë zotimet specifike të bëra sipas Nenit 4 dhe 5 nga çdo anëtar i CEFTA-s përmes krijimit të barrierave të panevojshme në tregti dhe që logjikisht nuk do të mund të priteshin në kohën kur u bënë ato zotime specifike, duhet të ishin në përputhje; përndryshe anëtari i CEFTA-s do të bënte shkelje të detyrimeve të tij sipas PSH 6.²⁷

Duhet theksuar se kriteret në Nenin 10.5 janë të gjera dhe varen nga interpretimi, në veçanti nëse një masë e kufizon tregtinë më shumë seç duhet ose nëse ndonjë masë e veçantë nuk mund të pritej në kohën kur u bënë zotimet. Prandaj mund të jetë jashtëzakonisht e vështirë të vlerësohet nëse një rregullim i caktuar i brendshëm është në përputhje me kriteret e përcaktuara.

Rregullimet e brendshme që nuk janë në përputhje me kërkesat nga Neni 10.5 duhet të vihen në përputhje; përndryshe Anëtari përkatës shkel detyrimet e tij nga Neni PSH 6.²⁸ Mirëpo, kriteret

²⁷ Fushëveprimi dhe ndikimi i Nenit 10.5 kufizohen edhe më tutje për faktin se ai zbatohet vetëm për kërkesat për shfuqizim ose zhvlerësim. Një shkelje e thjeshtë e detyrimeve në Nenin 10.5 nuk mund të përdoret si bazë për kërkesë, parashtruesi i kërkesës do të duhet të tregojë se një zotim i veçantë është shfuqizuar ose zhvlerësuar përmes një rregulloreje kombëtare që nuk është në përputhje me kërkesat nga ai Nen.

²⁸

janë aq të gjera dhe varen aq shumë nga interpretimi, të paktën derisa të jenë zhvilluar disiplinat e parashikuara në paragrafin 8 të Nenit 10, është vështirë të jepet përgjigje në pyetjen nëse një rregullim i caktuar i brendshëm është në përputhje me detyrimet.²⁹ Në çdo rast do të ishte e përshtatshme për autoritetet e Kosovës të bëjnë një kontroll rregullator për të vlerësuar shkallën në të cilën rregullimi i brendshëm që merret me kërkesat për kualifikim dhe licencim dhe standardet teknike në ata sektorë të shërbimeve në të cilët ka ndërmarrë zotime specifike mund të mos jenë në përputhje me obligimet detyruese të cilat Kosova i ka përvetësuar në këtë fushë sipas PSH 6. Për më tepër, është një numër i konsiderueshëm i shërbimeve në rastin e Kosovës të cilat akoma nuk janë rregulluar. Do të ishte e këshillueshme që kriteret e parashikuara në Nenin 10.5 të merren si udhëzues kur të hartohet dhe zbatohet ndonjë rregullore e re, pasi që ai paraqet në masë të madhe praktikatat më të mira rregullatore ndërkombëtare.

Në fund, Kosova ka përvetësuar në kuadër të PSH 6 zotime specifike për një numër të konsiderueshëm të shërbimeve profesionale. Siç e thotë Neni 10.7, *“Në sektorët ku janë ndërmarrë zotime specifike lidhur me shërbimet profesionale, çdo Palë siguron procedura adekuate për të verifikuar kompetencën e profesionistëve të cilësdo Palë tjetër”*. Do të thotë se procedurat duhet të jenë në fuqi dhe funksionale. Kjo është një fushë në të cilën do të nevojitet një veprim i menjëhershëm në mënyrë që Kosova të të jetë në pajtueshmëri me detyrimet e saj pasi Protokollin të hyjë në fuqi. Procedurat për fushëzbatim dhe ndikim të Nenit VI:5 të GATS janë edhe më të kufizuara nga fakti se ai zbatohet vetëm për pretendimet e shfuqizimit ose dështimit. Një shkelje e thjeshtë e detyrimeve në Nenin VI:5 nuk mund të përdoret si bazë për kërkesë, parashtruesi i kërkesës do të duhet të tregojë se një zotim i veçantë është shfuqizuar ose zhvlerësuar me një rregullore kombëtare e cila nuk është në përputhje me kërkesat nga Neni VI:4 GATS 2016, *“Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës”*. Ligji nuk është ende funksional. Akoma nuk është formuar Agjencia Shtetërore për Ekzaminim e Kosovës (ASHEK), dhe në mes të çështjeve tjera ligji mandaton miratimin e akteve të ndryshme nënligjore, gjë e cila ende nuk është bërë.³⁰ Këtu nuk është vendi për të shtjelluar të gjitha veprimet të cilat do të ishin të nevojshme që Kosova të përmbushë detyrimet e saj. Por, është me rëndësi të theksohet se është kjo një fushë që duhet të merr vëmendje parësore në të ardhmen e afërt.

4.3 Pagesat dhe Transferet

Neni 14 i PSH 6 rregullon pagesat dhe transferet në lidhje me shërbimet e përfshira në zotimet specifike, gjegjë të shënuara në planin e një Anëtarit, pavarësisht nga mënyra e ofrimit që e përmban. Paragrafi 1 parashikon që *“Pala nuk zbaton kufizime në transferet dhe pagesat ndërkombëtare për transaksionet rrjedhëse me Palën tjetër që lidhen me zotimet e saj specifike”*. Prandaj, asnjë kufizim nuk mund të shënohet në planet e Anëtarëve, pasi të jetë përfshirë transaksioni i shërbimit si i tillë. Transferet dhe pagesat ndërkombëtare përfshijnë transaksione të brendshme dhe të jashtme ndërkufitare ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve të një anëtarit. Sipas Nenit XXX (d) të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar, transaksionet rrjedhëse janë çdo pagesë përveç transferimit të kapitalit.

²⁹ Neni 10.8 thotë se *“Palët shqyrtojnë çështjet e rregullimit të brendshëm brenda dy vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij Protokollin. Me kërkesë të një apo më shumë Palëve, Palët hyjnë në negociata për disiplinat e rregullimit të brendshëm të cilat do të përfshihen në këtë Protokoll, si Shtojcë ose në mënyrë tjetër”*.

³⁰ Për shembull Neni 10.5(5,2) i Ligjit Nr 05/L-066 thotë se trajtimi i profesionistëve që kanë marrë të drejtën të ushtrojnë një profesion të rregulluar jashtë Kosovës përcaktohet me një akt të veçantë nënligjor, i cili ende nuk është miratuar.

Kjo dispozitë luan rol vendimtar në sigurimin e vlerës së zotimeve specifike të ndërmarra nga anëtarët e CEFTA-s në kuadër të PSH 6; pasi vlera e zotimeve specifike për qasjen në treg dhe trajtimin kombëtar do të mund të dëmtohej seriozisht nëse ato mund të kufizojnë transferet dhe pagesat ndërkombëtare për shërbime në sektorët e planifikuar. Ky detyrim duhet të zbatohet, për shembull në raste të tjera, kur një ofruar i huaj i shërbimeve i pranishëm në Kosovë – qoftë ai si prani komerciale apo si person fizik përmes Modalitetit 4 – i cili dëshiron që pagesat për shërbimet e ofruara të transferohen drejtpërdrejtë jashtë vendit, për shembull punëtorët e huaj të cilët dëshirojnë t'u transferohen pagat e tyre drejtpërdrejtë në vendin e tyre amë, apo degët e huaja të cilat duan që pagesat nga klientët t'u bëhen drejtpërdrejtë në kompaninë amë jashtë vendit.³¹ Ky detyrim duhet të shihet më tepër si konkluzion i detyrimeve tjera të GATS. Kjo nuk e shton një detyrim tjetër, por më tepër i kufizon mënyrat në të cilat qeveritë mund të përpiqen të zvogëlojnë ndikimin e zotimeve të tyre specifike.

Sa i përket pagesave dhe transfereve, aktualisht nuk ka kufizime në lidhje me përdorimin e EURO-s në fuqi në Kosovë; përveç raportimit tek Dogana e Kosovës mbi largimin ose importimin e EURO 10,000. Mirëpo, ky detyrim vendos kufi në kufizime në pagesat rrjedhëse që do të mund të vendosen në të ardhmen të cilat prekin zotimet e planifikuara.

Neni 14, Paragrafi 2, i PSH AP 6 shkon përtej transfereve dhe pagesave rrjedhëse, përfshirë edhe detyrimet që lidhen me transferet e kapitalit, të cilat janë të një rëndësie vendimtare në veçanti për efikasitetin e zotimeve të ndërmarra në Modalitetin 3, për themelimin. Ai thotë se, *“Nëse Pala ndërmerr zotimin për qasje në treg në lidhje me ofrimin e shërbimit përmes një mënyre të ofrimit nga Neni 2 paragrafi 2, dhe nëse lëvizja ndërkufitare e kapitalit është pjesë thelbësore e vet shërbimit, me këtë ajo Palë është zotuar se do të lejojë lëvizjen e kapitalit në atë mënyrë. Nëse Pala ndërmerr zotimin për qasjen në treg lidhur me ofrimin e shërbimit përmes mënyrës së ofrimit nga Neni 2 paragrafi 2, ajo zotohet me këtë se do të mundësojë transfere përkatëse të kapitalit në territorin e vet”*. Ky detyrim shkon përtej Nenit XI të GATS-it për pagesa dhe transfere, i cili rregullon pagesat dhe transferet rrjedhëse në lidhje me zotimet dhe kufizimet në transferrin e kapitalit që nuk janë në përputhje me to.³² Nuk është e qartë nëse formulimi i Nenit 14.2 përfshin edhe detyrimin për të mundësuar riatdhësimin e fitimeve dhe kapitalit si pjesë qenësore të vet shërbimit, alternative të cilën fjalia e dytë e Nenit 14.2 duket se e përjashton.³³ Sidoqoftë në Kosovë, në lidhje me Modalitetin 3, Neni 9 i Ligjit Nr 04/L-220 për Investime të Huaja, për shkëmbim të valutës dhe transferet e garantuara, garanton të drejtën e investitorëve të huaj për të bërë lirshëm transfere rrjedhëse dhe riatdhësim falas të fitimeve dhe kapitalit.

³¹ Shtrohet pyetja nëse ky detyrim ndalon ndonjë kufizim të eksporteve të valutës të destinuara për të paguar për konsum jashtë vendit sipas Modalitetit 2, siç janë shumat maksimale të valutës kombëtare të cilat u lejohen turistëve t'i marrin me vete, kufizimet për përdorim të kartelave kreditore jashtë vendit, etj.

³² Neni XI.2 i GAT thotë si në vijim: “Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të prekë të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar sipas Neneve të Marrëveshjes mbi Fondin, përfshirë shfrytëzimin e veprimeve të shkëmbimit që janë në përputhje me Nenet e Marrëveshjes, me kusht që Anëtarit nuk vendos kufizime për çdo transaksion të kapitalit në kundërshtim me zotimet e tij specifike lidhur me transaksionet e tilla, përveç Nenit XII ose me kërkesë të Fondit”. Ky formulim tregon se çdo kufizim në transferimin e kapitalit, qoftë hyrës ose dalës, i cili është në kundërshtim me zotimet specifike do të shkelë zotimet specifike.

³³ Fusnota e Nenit XVI i GATS-it për qasje në treg merret me lëvizje të caktuara të kapitalit që kanë të bëjnë me ofrimin e një shërbimi. Detyrimet nën këtë fusnotë mund të mos bëhen subjekt i kufizimeve, por ekzistojnë vetëm aty ku është bërë një zotim i veçantë. Ato zbatohen vetëm në dy ose katër modalitete të furnizimit: (i) në modalitetin e ofrimit ndërkufitar (Modaliteti 10, lëvizjet e kapitalit, qoftë brenda ose jashtë territorit të Anëtarit, duhet të lejohen nëse ato janë pjesë qenësore e shërbimit të ofruar, siç është pagesa e një kërkesë sigurimi; (ii) në praninë komerciale mënyra e ofrimit (Modaliteti 3), qarkullimet e ngjashme të kapitalit. Duhet theksuar se kufizimet për lëvizjet e kapitalit që nuk janë përmendur në këtë fusnotë, për shembull riatdhësimi i të ardhurave nga likuidimi në rrjedhjet tjera të kapitalit, mund të përfshihen aty ku ato "prekin tregtinë e shërbimeve", në veçanti mundësinë e barabartë konkurruese të ofruesve të huaj.

Kufizimet e kontrollit të këmbimit nuk përjashtohen nga fushëveprimi i këtij neni, përveç nëse justifikohen me përjashtim të bilancit të pagesave (Neni 15 i PSH 6). Sipas paragrafit 3 të Nenit 14, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) nuk do të preken, për sa kohë që nuk vendosen kufizime në transaksionet e kapitalit të përfshira në zotimet specifike. Mirëpo, FMN mund të kërkojë që një Anëtar të vendosë kufizime të tilla. Çdo kufizim për të mbrojtur bilancin e pagesave të miratuara apo ruajtura nga një Palë e CEFTA-s sipas dhe në përputhje me Nenin XII të GATS-t konsiderohet se është në përputhje me PSH 6. Protokolli nuk ka përfshirë shprehimisht kushtet që duhet plotësuar kur vendosen masat për të mbrojtur Bilancin e Pagesave siç parashikohet në **Nenin XII.2** të GATS-it.³⁴ Mirëpo, duhet të kuptohet se referimi në Nenin XII të GATS-it duhet të përfshijë, jo vetëm masat e ndërmarra sipas Nenit 15 të PSH 6. Sidoqoftë, kjo është një çështje e cila do të përfitonte nga sqarimi i mëtutjeshëm.

³⁴ Neni XII.2. i GATS “ Kufizimet nga paragrafi 1: (a) nuk bëjnë diskriminim ndërmjet Anëtarëve; (b) janë në përputhje me Nenet e Marrëveshjes mbi Fondin Monetar Ndërkombëtar; (c) shmangin dëmtimin e panevojshëm të interesave tregtare, ekonomike dhe financiare të çdo Anëtari tjetër; (d) nuk i tejkalojnë ato që nevojiten për rrethanat e përshkruara në paragrafin 1; dhe, (e) janë të përkohshme dhe ndërpriten gradualisht pasi të përmirësohet situata e cekur në paragrafin 1.”

V. Zotimet Specifike

Planet e zotimeve të PSH 6 në përgjithësi përputhen me formatin standard, i ngjashëm me atë të përdorur në negociatat për GATS, me zotimet e ndara në dy pjesë: *Zotimet horizontale* që cekin kufizimet të cilat vlejné për të gjithë sektorët e përfshirë në planin e anëtarit; dhe më pas listën e *zotimeve për sektorë specifik* sipas sektorit, të cilat identifikohen në përgjithësi duke përdorur Listën e Klasifikimeve të Shërbimeve Sektoriale të OBT. Në PSH 6 planet janë shtjelluar vazhdimisht me praktikën e planifikimit të GATS, siç parashikohet me Udhëzuesit e Planifikimit.

Zotimet e përvetësuar nga Kosova janë paraqitur në Shtojcë. Si për zotimet horizontale, ashtu edhe ato për sektorë specifik, ka hyrje për “qasjen në treg” dhe “trajtimin kombëtar” në dy shtylla të veçanta dhe zotimet janë të detajuara nëpër rreshta për të katër modalitetet e ofrimit siç është përcaktuar në Protokoll; dhe mbishkrimet e bëra për secilën nga katër modalitetet: ndërkufitar, konsumi jashtë vendit, prania komerciale dhe prania e personave fizik dhe mund të marrin tri forma: *‘I padetyrueshëm’*, *‘Asnjë’* dhe kufizimet e specifikuar, për të treguar se nuk ka zotime, zotime të plota ose të pjesshme. Prandaj detyrimet e një vendi në një sektor specifik mund të përcaktohen duke i lexuar kufizimet e tij sektoriale dhe çdo kufizim të zbatueshëm horizontal të shkruar në fillim të planit të tij.

5.1 Zotimet Horizontale

Zotimi horizontal zbatohet për tregtinë e shërbimeve në të gjithë sektorët e shërbimeve të planifikuara përveç nëse ndryshe specifikohet. Kjo në fakt kufizon, ose masën që paraqet kufizim për qasjen në treg ose trajtimin kombëtar ose një situatë ku nuk ka kufizime të tilla. Në PSH 6 Kosova, si Palët tjera të CEFTA-s, ka bërë zotime të kufizuara horizontale. Kjo pjesë analizon shkurtimisht ato zotime.

Sa i përket Modalitetit 3, Kosova ka kufizuar të drejtën e personave fizik dhe juridik të vendeve të tjera të CEFTA-s që të fitojnë të drejtat në pasuri të paluajtshme, “përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj (kufizimet jodiskriminuese)”. Kjo nuk vlen për tokën bujqësore dhe pyjore ku zbatohen kufizimet. Do të thotë se një person nga një vend i CEFTA-s duhet të ketë të drejtën të fitojë të drejtat në pasurinë e paluajtshme, me përjashtim të tokës bujqësore dhe pyjore, në të njëjtën pozitë me shtetasit e Kosovës. Trajtimi kombëtar është kufizuar në këtë drejtim. Çdo masë që kufizon qasjen në të drejtat e pasurisë së paluajtshme, e cila diskriminon, *de jure* ose *de facto*, personat nga palët e CEFTA-s do të jetë në kundërshtim me zotimin e miratuar nga Kosova nëse *asnjë* është mbishkruar në këtë mënyrë të ofrimit në pjesën e zotimeve sektoriale të planit.

Sa i përket tokës bujqësore dhe pyjore, zotimi nuk specifikon cilat kufizime zbatohen, që nuk janë në përputhje me udhëzimet e planifikimit të GATS të cilat kërkonin qartë që planet duhet të cekin kufizimet e mbetura dhe të përshkruajnë në hollësi masat që nuk janë në përputhje me qasjen në treg ose trajtimin kombëtar për të cilat qeveria rezervon të drejtën për parashtrim të kërkesës. Ky nuk ishte rasti dhe nuk janë fare të qarta në plan kufizimet që prekin qasjen në tokën bujqësore dhe pyjore nga të huajt.

Një mbishkrim i rëndësishëm si zotim horizontal i miratuar nga të gjitha palët e CEFTA-s i përket “shërbimeve komunale”, që në praktikë do të mund të përjashtonin disa sektorë të shërbimeve nga përmbajtja e marrëveshjes.³⁵ Sektorët e përfshirë shkojnë përtej asaj që zakonisht kuptohet si

³⁵ “Shërbimet e konsideruara si shërbime komunale në nivel kombëtar ose lokal mund të jenë subjekt i monopoleve publike ose të drejtave ekskluzive të dhëna për operatorët privat. Këto mund të ekzistojnë në fushat në vijim: shërbimet e energjisë; uji; shërbimet e transportit publik dhe shërbimet ndihmëse për të gjitha mënyrat e transportit; shërbimet për këshillim shkencor dhe teknik; shërbimet kërkimore dhe zhvillimore për shkencat shoqërore dhe njerëzimit; shërbimet e testimit dhe analizës teknike; shërbimet mjedisore; shërbimet e shëndetit publike dhe shoqërore publike; shërbimet e komunikimit dhe shërbimet e arsimit publik. Të drejtat ekskluzive për shërbime të tilla mund t’u jepen operatorëve kombëtar ose lokal privat me preferencë”.

shërbime komunale si të tilla dhe përfshijnë gjithashtu edhe disa aktivitete shërbimesh që do të cilësoheshin si “shërbime të ofruara në ushtrimin e autoritetit qeveritar”, të cilat përjashtohen vetvetiu nga qëllimi përcaktues i Marrëveshjes. Në lidhje me shërbimet që mbulohen nga ky kufizim horizontal, anëtarët e CEFTA-s kanë rezervuar të drejtën të mbajnë ose krijojnë monopole publike ose t’u jepen të drejta ekskluzive operatorëve privat, përfshirë dhënien e të drejtave ekskluzive operatorëve kombëtar ose lokal me preferencë.

Edhe pse ky kufizim horizontal është përvetësuar njëkohësisht në disa sektorë të cilët i mbulon ai, shumica e vendeve të CEFTA-s kanë ka përvetësuar zotimet për liberalizim të plotë. Këto janë rastet për shembull të shërbimeve kërkimore dhe zhvillimore (KQP 851-853), shërbimet e testimit dhe analizës teknike (KQP 8676); shërbimet e komunikimit (KQP 841); dhe shërbimet mjedisore (KQP 9401-9406). Prandaj, me rezervimin e të drejtës për të vendosur kufizime në disa sektorë, shumica e vendeve të CEFTA-s kanë miratuar zotimet e plota në disa nga ata sektorë. Qëllimi i kufizimit horizontal në këto raste nuk është fare i qartë, pasi është përjashtuar mundësia e përdorimit të tij nga zotimet sektoriale. Çështje tjetër është se kufizimet horizontale nuk kanë lidhje me numrin korrespondues të KQP-s, kështu që do të jetë e ndërlikuar të vlerësohet realizimi i detyrimeve nëse një vend i CEFTA-s vendos të fut të drejtat ekskluzive në të ardhmen.³⁶

Të gjithë anëtarët e CEFTA-s kanë kufizuar zotimet e tyre në Modalitetin 4, pra lëvizja e personave fizik, në një grup kategorish të personave fizik që ofrojnë shërbime, të cilët janë përcaktuar në Shtojcën 1 të PSH 6. Këto kategori janë: vizitorët afarist; të transferuarit përbrenda ndërmarrjes; praktikantët; shitësit e shërbimeve afariste; ofruesit e shërbimeve kontraktuese; profesionistët e pavarur; dhe vizitorët afatshkurtër për qëllime afariste. Kosova ka bërë zotime të zgjeruara sektoriale në Modalitetin 4 duke shënuar në shtyllat për qasjen në treg dhe trajtimin kombëtar “asnjë”. Do të thotë se nuk do të ketë kufizime dhe do t’u ofrohet trajtim i plotë kombëtar për ata të huaj që kualifikohen për kategoritë e dakorduara që hyjnë në Kosovë.

Puna dhe punësimi i të huajve në Kosovë rregullohen me Ligjin Nr.04/L-219 të vitit 2013, dhe Ligjin Nr.06/L-036 për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit Nr.04/L-219, të vitit 2018. Duhet të rishikohet pajtueshmëria ndërmjet ligjeve ekzistuese dhe zotimeve të përvetësuar nga Kosova për Modalitetin 4 për të vlerësuar nëse ekziston ndonjë kundërshtim i mundshëm. Në çdo rast, hyrja dhe qasja në punë për ata individë që përfshihen në zotimet sektoriale nuk mund t’i nënshtrohen më testit për nevojë ekonomike siç përcaktohet me ligjin për të huajt. Lejet e qëndrimit dhe punës, nëse nevojiten, duhet të jenë jashtë çdo kuote që do të mund të përcaktohej sipas kornizës ligjore.

5.2 Zotimet Sektoriale

Zotimet sektoriale të miratuara nga Kosova janë paraqitur në Shtojcë të këtij dokumenti. PSH 6, siç është rasti i GATS, nuk përkufizon se çfarë janë shërbimet, por shërbimet duhet të klasifikohen për funksionimin e Marrëveshjes, pasi zotimet specifike për qasjen në treg dhe trajtimin kombëtar janë përfshirë në planin e Anëtarit në bazë sektoriale. Përshkrimi sektorial në plan përcakton përfshirjen e zotimeve përkatëse dhe për këtë arsye është vendimtar në përcaktimin e natyrës dhe qëllimit të çdo zotimi të caktuar të ndërmarrë. Përveç kësaj, siç u shtjellua më lartë, disa detyrime të përgjithshme të rëndësishme sipas PSH AP6 vlejné vetëm për sektorët ku ndërmerren zotime specifike, siç është rasti, për shembull me detyrimet lidhur me rregullimin e brendshëm dhe për pagesat dhe transferet. Për më tepër, edhe për detyrimin e përgjithshëm për Trajtimin e Kombit më të Favorizuar (Neni 3) i cili vlen për çdo masë që prek tregtinë e shërbimeve, pavarësisht nëse ato shërbime janë apo nuk janë renditur në plan, duhet gjithashtu të identifikohet shërbimi përkatës

pasi bëhet fjalë për trajtimin e dakorduar për shërbimet dhe ofruesit e shërbimeve të ngjashme midis anëtarëve.³⁷

Duke ndjekur praktikën e GATS-it, vendet e CEFTA-s kanë planifikuar në përgjithësi zotimet e tyre sipas Listës së Klasifikimeve të Shërbimeve Sektoriale të OBT-s (MTN.GNS/W/120), i cili është klasifikim që bazohet në Klasifikimin e Përkohshëm Qendror të Produkteve (KPQP) të KB-s, i cili e vendos një marrëdhënie të nënkuptuar midis tyre.³⁸ Sektorët e renditur në W120 mund të identifikohen në KQP me numër përkatës. Planifikimi i zotimeve specifike sipas PSH 6 ka bërë referencë të drejtpërdrejtë në KQP të Përkohshme dhe në disa sektorë në versionin 2 të KQP-s³⁹, duke shënuar ndarjen, grupin, klasën ose nën-klasën e shërbimeve për të cilat vlejnjë zotimet.⁴⁰ KQP-ja është shumë e zbrëthyer dhe ajo e bën dallimin midis gati 600 shërbimeve, duke mundësuar zotime shumë specifike dhe të fokusuara.⁴¹

Natyrë juridike e planit, si dhe nevoja për të vlerësuar zotimet, kërkojnë shkallën më të lartë të mundshme të qartësisë në përshkrimin e çdo sektori ose nën-sektori të planifikuar dhe të çfarëdo klasifikimi të cilin një qeveri ka vendosur ta mbaj dhe shkruaj në planin e saj. Klasifikimi i një sektori/nën-sektori mund të ketë implikime të konsiderueshme për vendet Anëtare pasi mund të përcaktojë natyrën dhe qëllimin e çdo zotimi të caktuar i cili është ndërmarrë. Për të vlerësuar thellësinë dhe qëllimin e zotimeve të përvetësuar nga Kosova, është me rëndësi të theksohen disa çështje të përgjithshme në lidhje me zotimet në PSH 6 në frymën e përvojës dhe jurisprudencës së GATS-it, pasi ato janë të rëndësishme për të kuptuar natyrën dhe qëllimin e zotimeve nga PSH 6 dhe implikimet e tyre të mundshme. Në këtë drejtim, janë të rëndësishme katër çështje: fushëveprimi i zotimeve, standardi i trajtimit, neutraliteti teknologjik dhe relacioni midis Modalitetit 1 dhe Modalitetit 2.

Fushëveprimi i zotimeve

Kur një Anëtar bën zotim për qasjen në treg në një sektor ose nën-sektor, ai zotim përfshin të gjitha shërbimet që hyjnë në këtë fushëveprim të atij sektori ose nën-sektori. Një anëtar nuk i përmbush detyrimet nëse mundëson qasjen në treg për vetëm disa nga shërbimet e përfshira nga një sektor ose nën-sektor i zotuar ndërsa ndalon të gjithë të tjerët. Siç konfirmohet nga Organi i Apelitimit i OBT "pasi KQP është sistem decimal, referenca në kategori grupore duhet të kuptohet si referencë në të gjitha pjesët përbërëse të asaj kategorie. Me fjalë të tjera, referenca në Grupin KQP treshifror duhet, në mungesë të ndonjë treguesi për të kundërtën, të kuptohet si referencë në të gjitha Klasat katërshifrore dhe që përbëjnë grupin; dhe referenca në të gjitha Nën-klasat pesëshifrore që e

³⁷ Zhang Rousi (2015). "Të përfshira ose të papërfshira: Kjo është çështja – Klasifikimi i shërbimeve dhe implikimet e tij për zotime specifike sipas GATS-it". Dokument Pune i Stafit të OBT-s, Nr ERSD-2015-11. Organizata Botërore e Tregtisë.

³⁸ Por, në negociatave për GATS janë gjithsej katër shembuj të sektorëve ku shfrytëzimi i qasjeve të planifikuara ad-hoc në krahasim me referencën në KQP është dakorduar nga anëtarët e OBT-s. Këto janë shtojca e transportit ajror, planifikimi i zotimeve në marrëveshjen për telekomunikacionin bazik, shtojca e shërbimeve financiare dhe skema e modelit të planit në transportin detar.

³⁹ Publikimi i Kombeve të Bashkuara: ST/ESA/STAT/SER.M/77/Ver.2.2008. Zotime për sektorët në vijim janë shënuar në bazë të KQP Rev 2: Shërbimet e dizajnit special (KQP 87905; shërbimet postare dhe koriere KQP 681 dhe 682); shërbimet e telefonisë dhe komunikimit; (KQP 841); shërbimet e telekomunikacionit në internet (KQP 842); dhe përmbajtja në internet (KQP 843). Problemi që mund të lindë është krahasueshmëria e zotimeve nga vendet e CEFTA-s nën PSH dhe në GATS.

⁴⁰ Kierarkia e KQP përbëhet nga Pjesët e përcaktuara me kode njëshifrore, Ndarjet e përcaktuara me kode dyshifrore, Grupet e përcaktuara me kode treshifrore, Klasat e përcaktuara me kode katërshifrore dhe nën-klasat e përcaktuara me kode pesëshifrore.

⁴¹ Çdo version i ri i KQP thotë në hyrjen e tij se "të gjitha draft versionet e mëparshme janë të vjetruara". Krahasuar me versionin e përkohshëm të vitit 1991, dy versionet e fundit të Rev 2, dhe 2.1, përmbajnë ndryshime të rëndësishme, në veçanti ato me zhvillimet e shpejta në shërbime. Në këtë kontekst, shtrohet pyetja nëse W/120 ishte akoma i përshtatshëm për t'i shërbyer negociatave për PSH 6 të CEFTA-s dhe atyre të ardhshme. Një arsye mund të ketë qenë të ruhet konsistenca me zotimet e përvetësuar në bazë të GATS nga vendet e CEFTA-s Anëtare të OBT-s.

përbëjnë atë Klasë”.⁴² Kjo nënkupton se zotimi specifik në një sektor ose nën-sektor është garanci se i tërë ai sektor, gjegjësisht të gjitha shërbimet e përfshira në atë sektor ose nën-sektor përfshihen në atë zotim. Nëse një anëtar i CEFTA-s do të kishte dashur të kufizonte qasjen në treg lidhur me shërbime të caktuara që hyjnë në një sektor ose nën-sektor, ai do të duhej të caktojë restriksionet ose kufizimet për qasje në vend të përshtatshëm në planin e tij.

Shumica e zotimeve specifike të bëra nga Kosova në PSH 6 kanë qenë në nivel tre dhe katër shifror të KQP; në disa sektorë zotimi është shënuar në nivelin pesëshifror, i cili ofron më shumë fushëveprim më të fokusuar të aktiviteteve të përfshira. Mirëpo, në lidhje me disa sektorë të shërbimeve, zotimet e vendeve të CEFTA-s, përfshirë Kosovën, janë bërë në nivel të Divizionit (dyshifror) që do të thotë se të gjitha aktivitetet e përfshira në atë divizion përfshihen në zotimet specifike që janë bërë. Këto janë rastet e shërbimeve kompjuterike dhe të ngjashme (KQP 84); shërbimet e marrjes dhe dhënies me qira pa operator (KQP 83); dhe shërbimet e distribuimit (KQP 61 dhe 62). Kjo nënkupton se të gjitha shërbimet e përfshira në ato divizione janë përfshirë në zotimet specifike të bëra, në lidhje me atë që Kosova e ka obliguar veten për detyrimet e qasjes në treg dhe trajtimin kombëtar. Në rastin e shërbimeve bankare, nuk ka referencë në numrin përkatës të KQP, i cili u tregua problematik në rastin e vlerësimit të përmbushjes së detyrimeve nga PSH 6.

Një çështje që duhet theksuar është se në KQP, në shumë sektorë gjendet një kategori “Shërbimet tjera **n.e.c**”, të cilat do të përfshiheshin gjatë përvetësimit të zotimeve në nivele të ndryshme të KQP. Nëse kjo kategori shprehimisht nuk është përjashtuar nga zotimet, do të thotë se çdo shërbim i ri që paraqitet dhe që do të mund të klasifikohet nën këtë divizion, grup ose klasë, do të përfshihet automatikisht në zotimet e ndërmarra nëse ato përvetësohen në mënyrë të duhur nga zotimet dhe me këtë nga klasifikimet përkatëse. Për të kuptuar implikimin e mundshëm të kësaj, ia vlen të krahasohen shërbimet e ndryshme kompjuterike, të përfshira në KQP të përkohshëm (Divizioni 84) dhe KQP 2.1 i publikuar në vitin 2015 (Divizioni 83); ky i fundit ka përfshirë një numër të konsiderueshëm të shërbimeve kompjuterike që nuk ekzistonin kur është miratuar KQP i Përkohshëm.⁴³

Standardi i Trajtimit

Në PSH 6 vendet e CEFTA-s kanë ndërmarrë, si në GATS, qasjen e standardit për trajtim minimal, duke iu garantuar ofruesve të shërbimeve nga vendet e tjera të CEFTA-s që barrierat në tregtinë e shërbimeve nuk do të tejkalojnë ato të planifikuara në Planin e Zotimeve të Planifikuara të anëtarit. Detyrimi që del nga përvetësimi i zotimeve specifike sipas PSH 6 është t'i ofrohet shërbimeve dhe ofruesve të shërbimeve të çdo anëtarit tjetër të CEFTA-s *trajtim jo më pak të favorshëm* se sa që parashikohet me afatet, kushtet dhe kushtet e specifikuar në Planin e zotimeve specifike të vendit. Do të thotë se një anëtar nuk mund të vendos një regjim tregtar më kufizues se ai që është përcaktuar në zotimet e tij specifike. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se një vend nuk mund të ketë një regjim tregtar më liberal në fuqi. Prandaj, ka mundësi që të ketë dallime midis nivelit të kufizimit të kufizueshmërisë tregtare dhe regjimit të tanishëm tregtar. Dallimi quhet “liberalizimi është bërë, por len hapësirë të caktohen kufizimet që nuk ekzistojnë por janë të lejueshme (water in the schedules)”. Për shumicën, Kosova ka kufizuar regjimin e tanishëm tregtar, i cili rregullon sektorë të ndryshëm të shërbimeve. Një ushtrim që duhet të zhvillohet, i cili është

⁴² Raporti i Panelit për Shtetet e Bashkuara – Masat që Prekin Ofrimin Ndërkufitar të Shërbimeve të Lojërave të Fatit dhe Basteve (sfiduesi Antigua dhe Barbuda) WT/DS 285/R, ka qarkulluar më 10 nëntor, 2004, gjendet në <http://www.wto.org/english/tratop e/dispu e/285 e.pdf> Also, Raporti i Organit të Apelimit për SHB - Masat që Prekin Ofrimin Ndërkufitar të Shërbimeve të Lojërave të Fatit dhe Basteve, WT/DS285/AB/R ka qarkulluar më 7 prill 2005

përtej qëllimit të këtij dokumenti, është vlerësimi i shtrirjes së "water" në plane të të gjithë anëtarëve të CEFTA-s për ta kuptuar më mirë shtrirjen reale të liberalizimit ekzistues të tregtisë së shërbimeve në regjion.⁴⁴

Neutraliteti Teknologjik

Në kontekstin e GATS-it, parimi i neutralitetit teknologjik duket se përgjithësisht pranohet në kuptimin që Marrëveshja nuk bën kurrfarë dallimi ndërmjet mjeteve të ndryshme teknologjike përmes të cilave mund të ofrohet një shërbim – qoftë personalisht, me postë, telefon ose përmes internetit. Ky interpretim bazohet në atë në regjimin juridik të OBT-s i cili rregullon që një transaksion i caktuar të përcaktohet nga natyra e produktit që tregtohet, e jo sipas teknikës së prodhimit ose mënyrës së dërgimit, si dhe në bazë të disa vendimeve të Organit për Zgjidhje të Mosmarrëveshjeve (OZM). Mirëpo, interpretimi i OZM-s në disa raste është kritikuar nga analistë të ndryshëm si një shembull i tejkalimit gjyqësor.

Por duhet theksuar se kjo çështje nuk zgjidhet në nivel shumëpalësh. Për disa Anëtarë të OBT-s, GATS-i është thelbësisht teknologjikisht neutral, dhe zotimet e Anëtarëve duhet të interpretohen në bazë të teknologjive në zhvillim. Sipas mendimit të këtyre Anëtarëve, parimet e GATS-it zbatohen për ofrimin e shërbimeve me mjete elektronike dhe se zotimet për qasje në treg dhe trajtim kombëtar të bëra nga Anëtarët e OBT-s në Planet e tyre të GATS-it garantojnë kushte për qasje në treg dhe trajtim kombëtar të cilat detyrojnë secilin Anëtar të OBT-s që ato shërbime të ofrohen në format "tradicional", por edhe me mjete elektronike nëse mund të bëhet ofrimi i tij në këtë mënyrë. Për Anëtarët e tjerë, ky këndvështrim është tepër problematik pasi që kjo në thelb do të nënkuptonte se ato shërbime që thjeshtë nuk janë marrë parasysh nga Anëtarët gjatë përvetësimit të zotimeve specifike, do të supozohej se janë bërë nëse teknologjia evoluon në kohë, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve të tilla me mjete elektronike.⁴⁵

Kjo është një çështje komplekse me implikime të mundshme domethënëse në përcaktimin e fushëveprimit të zotimeve të përvetësuar nga vendet e CEFTA-s në PSH 6, të cilat do të duhet të adresohen sa më shpejtë të jetë e mundur, në mënyrë që të sigurohet qartësi dhe paarshtueshmëri për efektet e zotimeve specifike detyruese, të planifikuara nga të gjithë anëtarët e CEFTA-s në veçanti pasi të gjitha transaksionet elektronike janë përkufizuar si tregti e shërbimeve. Anëtarët e CEFTA-s duhet të shqyrtojnë me kujdes nëse këto zotime shtrihen në shërbimet që ofrohen në mënyrë elektronike përtej kufijve. Duhet seriozisht të merren parasysh pasojat e mundshme në fushat si sektorët e arsimit, mjekësor dhe shërbimet tjera të rregulluara.

Raporti midis Modalitetit 1 dhe Modalitetit 2

Në kuadër të GATS-it, çështja e ngritur për të cilën ka pasur mosmarrëveshje midis ekspertëve dhe midis Anëtarëve të OBT-s ka qenë nëse shërbimet në internet ofrohen si Modaliteti 1 ose Modaliteti 2.⁴⁶ Pyetja është nëse shërbimi i internetit është ofrim i shërbimeve përtej kufijve (Modaliteti 1) ose një konsumator "udhëton" jashtë vendit për të pasur qasje në shërbimin e internetit (Modaliteti 2). Kjo çështje nuk është thelbësisht e rëndësishme nëse një vend ka bërë saktësisht të njëjtat zotime të Modalitetit 1 dhe Modalitetit 2. Rishikimi i zotimeve të Kosovës në

⁴⁴ Për metodologji dhe vlerësim të ngjashëm i referoheni: Miroudot, S. dhe K. Pertel (2015), "Hapësira në GATS: Metodologjia dhe Rezultatet", Dokumentet e Politikës Tregtare e OECD. Nr. 185, Publikim i OECD-s, Paris. <http://dx.doi.org/10.1787/5jrs6k35nnf1-en>

⁴⁵ R.V.Anuradha (2018). "Neutraliteti Teknologjik: Implikimet për Zotimet e Shërbimeve dhe Diskutimet për Tregtinë-E", Dokumenti CWS/WP/200/51. Qendra për studime e OBT-s. Instituti Indian Ipër Tregtinë e Jashtme. Tetor

⁴⁶ Usman Ahmed, Brian Bieron, dhe Gary Horlick1 (2015). "Modaliteti 1, Modaliteti 2, ose Modaliteti 10: Si Duhet të Klasifikohen Shërbimet në Internet në Marrëveshjen Globale për Tregtinë e Shërbimeve?" Universiti i Bostonit. Revista e të Drejtës Ndërkombëtare: Temat Aktuale në të Drejtën Ndërkombëtare www.bu.edu/ilj Nëntor.

nivel sektorial tregon se në pjesën dërrmuese të sektorëve të shërbimeve, me përjashtim të shërbimeve të sigurimeve dhe ato bankare, zotimet e Modalitetit 1 dhe Modalitetit 2 të përvetësuara nga Kosova janë të njëjta. Prandaj, nuk duhet të ketë ndonjë problem madhor në interpretimin e zotimeve në sektorët përveç shërbimeve të sigurimit dhe ato bankare. Raporti midis Modalitetit 1 dhe Modalitetit 2 në shërbimet e sigurimit dhe ato bankare, sektorët ku qartësia është shumë e rëndësishme për shkak të implikimeve të mundshme në interpretimet e ndryshme, është një çështje që do të duhet të diskutohet në nivel të CEFTA-s dhe të arrihet një mirëkuptim i përbashkët rreth asaj se si të interpretohen zotimet *specifike* të miratuara nga vendet e CEFTA-s. E njëjta gjë në të gjithë këta sektorë ku raporti midis Modalitetit 1 dhe Modalitetit 2 nuk është zgjidhur plotësisht dhe është i rëndësishëm për të përcaktuar qëllimin e zotimeve të marra.

VI. Rruga në të ardhmen

Nga shtjellimi i mësipërm është e qartë se ekzistojnë disa çështje që duhet të preken posa të ratifikohet PSH 6 nga anëtarët e CEFTA-s dhe kur ai të hyjë në fuqi. Disa çështje kërkojnë përgjigje kombëtare në rastin e Kosovës; por janë disa të tjera që kërkojnë që të arrihet të kuptuarit e përbashkët midis vendeve të CEFTA-s mbi interpretimin e disa nga dispozitat e PSH 6. Siç është cekur, PSH 6 ka transpozuar disa nga çështjet e pazgjidhura në GATS të cilat janë subjekt i shtjellimit të sotëm. Përveç këtyre çështjeve, PSH 6 përfshin një agjendë të integruar, e cila duhet të merrë vëmendje prioritare nga MTI-ja.

Agjenda e integruar në PSH 6 parashikon negociata në tri fusha të rëndësishme. Siç thotë Neni 10.8, Palët i shqyrtojnë çështjet e rregullimit të brendshëm brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e PSH 6; dhe *“me kërkesë të njëres ose më shumë Palëve, Palët hyjnë në marrëveshje për disiplina të rregullimit të brendshëm të cilat do të përfshihen në këtë Protokoll, si Shtojcë ose në mënyrë tjetër”*. Është treguar se negociatat për disiplinat e rregullimit të brendshëm janë një çështje shumë komplekse në kuadër të GATS-it, dhe pas shumë vitesh negociatash akoma nuk ka ndonjë rezultat të qartë. MTI-ja duhet ta studjojë me kujdes procesin dhe çështjet përkatëse në negociatat për rregullimin e brendshëm të GATS për t'u përgatitur për përbashkëtimin me këto negociata në kuadër të PSH 6.

Përveç kësaj, Neni 20 i PSH 6 shqyrton negociatat për të liberalizuar më tej tregtinë e shërbimeve që duhet të zhvillohen jo më larg se tri vjet pas hyrjes në fuqi të Protokollit. Kjo është një fushë tjetër ku Kosova duhet të fillojë me kohë të gjitha vlerësimet e nevojshme analitike dhe punën e nevojshme përgatitore për të caktuar interesat e saj ofensiv dhe defensiv. Pritet që para çdo negocimi të bëhet një vlerësim i shkallës së kufizueshmërisë së masave, që prekin tregtinë e shërbimeve, duke përdorur metodologjitë e përcaktuara nga Banka Botërore dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE). Kjo detyrë është tashmë duke u zhvilluar nga një projekt i nisur nga Sekretariati i CEFTA-s, por para fillimit të negociatave, ky ushtrim duhet të përditësohet për ta kapur momentin e realitetit.

Në fund, Neni 11.4, thotë se *“Palët i përfundojnë proceset e nevojshme për të arritur një marrëveshje ose ujdë për njohjen e ndërsjellë të profesioneve të rregulluara pas hyrjes në fuqi të këtij protokoll”*. Ky proces është nisur nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (KBP) dhe ka arritur në vendndalo. Ky është një mandat që del nga PSH 6 dhe negociatat për forume të ndryshme, të cilat kanë përjashtuar një anëtar të CEFTA-s, ngre disa çështje që duhet seriozisht të trajtohen nga anëtarët e CEFTA-s.

Nuk ka mandat për të filluar negociatat për tregtinë elektronike. Neni 18.4 vetëm parashikon që Palët “bëjnë dialog mbi çështjet rregullatore të ngritura nga tregtia-e”.⁴⁷ Një çështje që duhet diskutuar dhe sqaruar, siç u theksua më lartë në frymën e diskutimeve të vazhdueshme lidhur me dispozitat e GATS-it, është si do të trajtohen transaksionet e shërbimeve ndërkufitare përmes internetit në kuadër të PSH 6, pasi ai barazon të gjitha transaksionet elektronike si tregti e shërbimeve; dhe ka shumë çështje të pazgjidhura dhe çështje të tjera që i përkasin transaksioneve të shërbimeve përmes internetit.

⁴⁷ Në mes tjerash dialogu do të trajtojë çështjet në vijim: (a) njohja e certifikatave të nënshkrimeve elektronike, të lëshuara për publikun dhe lehtësimin e shërbimeve ndërkufitare për çertifikim; (b) përgjegësia e ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse sa i përket transmetimit ose ruajtjes së informacionit; (c) trajtimi i komunikimeve të padëshiruara tregtare elektronike; (d) mbrojtja e konsumatorëve në kuadër të tregtisë elektronike; dhe, (e) çdo çështje tjetër relevante për zhvillimin e tregtisë elektronike.

SHTOJCA

PLANI I KONSOLIDUAR I ZOTIMEVE SPECIFIKE PËR TREGTINË E SHËRBIMEVE TË PALËVE TË CEFTA-s: KOSOVA

SHËNIME SHPJEGUESE

Ky “Plan i Konsoliduar i Zotimeve Specifike për Tregtinë e Shërbimeve të Palëve të CEFTA-s” bazohet në listën e Klasifikimit Qendror të Produkteve (KQP) i Kombeve të Bashkuara, e cila përdoret në negociatat e shërbimeve në Organizatën Botërore të Tregtisë, por ajo përfshin disa shërbime të përshkruara në versionin 2 të KQP-s (Publikimi i Kombeve të Bashkuara ST/ESA/STAT/SER.M/77/Ver.2).

Ky Plan është në përputhje me praktikën e planifikimit të GATS-it dhe tregon vetëm ata sektorë dhe nën-sektorë të shërbimeve ku Palët ndërmarrin zotime. Sa i përket zotimeve për qasjen në treg dhe trajtimin kombëtar, modalitetet e ndryshme të furnizimit të cekura në Plan janë si vijon:

Modaliteti 1: nga territori i një Pale në territorin e çdo Pale tjetër;

Modaliteti 2: në territorin e një Pale të një konsumuesi të shërbimit të çdo Pale tjetër;

Modaliteti 3: nga ofruesi i shërbimit të një Pale, përmes pranisë komerciale në territorin e çdo Pale tjetër; dhe

Modaliteti 4: nga ofruesi i shërbimit të një Pale, përmes pranisë së personave fizik të një Pale në territorin e çdo Pale tjetër.

Për qëllimin e këtij Plani, kur të gjitha Palët e CEFTA-s 2006 kanë ndërmarrë zotimet, kjo ceket me shënimin “Të gjitha Palët e CEFTA-s”.Përndryshe, zotimet nga Palët individuale ceken me shkurtesat në vijim, siç janë renditur në parathënien e CEFTA-s 2006, por duke përjashtuar Palët që janë tërhequr nga Marrëveshja në përputhje me Nenin 51. [Kosova është PVII]

A. ZOTIMET HORIZONTALE

1. Blerja e tokës dhe pasurisë së paluajtshme

PVII – Personat fizik dhe juridik të Palës tjetër mund të fitojnë të drejta në pasuri të paluajtshme në **PVII**, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj (kufizimet jodiskriminuese). Kufizimet zbatohen për tokën bujqësore dhe tokën pyjore.

3. Regjistrimi i kompanive

Të gjitha Palët e CEFTA-s– Zyra përfaqësuese është pjesë e kompanisë pa pasur statusin e personit juridik. Zyrat e tilla mund të merren me hulumtimin e tregut, aktivitetet promovuese ose përfaqësuese. Ato mund të mos kryejnë veprimtari tregtare.

4. Shërbimet publike

Të gjitha Palët e CEFTA-s:

Shërbimet që konsiderohen shërbime publike në nivel kombëtar dhe local mund të jenë subject i monopoleve publike ose të drejtave ekskluzive që u jepen operatorëve privat. Këto mund të ekzistojnë në fushat në vijim: shërbimet e energjisë; ujit; shërbimeve të transportit publik dhe shërbimeve ndihmëse për të gjitha mënyrat e transportit; shërbimet këshilluese shkencore dhe teknike; shërbimet kërkimore dhe zhvillimore për shkencat shoqërore dhe të njerëzimit; shërbimet e testimit dhe analizës teknike; shërbimet mjedisore; shërbimet e shëndetit publik dhe shoqëroro-publike; shërbimet e komunikimit dhe shërbimet e arsimit publik. Të drejtat ekskluzive mmund t'u jepen operatorëve privat kombëtar ose local në baza preferenciale.

5. Prania e personave fizik

Të gjitha Palët e CEFTA-s përveç **PV**:

Të padetyrueshme përveç për masat lidhur me hyrjen në dhe qëndrimin e përkohshëm të kategorive vijuese për personat fizik që ofrojnë shërbime: stafi kyç (vizitorët afarist; të transferuarit përbrenda ndërmarrjes; praktikantët; shitësit e shërbimeve afariste; ofruesit e shërbimeve kontraktuese; profesionistët e pavarur; dhe vizitorët afatshkurtër për qëllime afariste, siç përcaktohet në Shtojcën 1 të Protokollit Shtesë 6 për Tregtinë e Shërbimeve.

B. ZOTIMET SPECIFIKE

SEKTORI OSE NËN-SEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
1. SHËRBIMET AFARISTE		
Shërbimet Juridike (KQP 861)		
Shërbimet Juridike (861) – Konsulencë për jurisdikcionin amë, ligji i huaj dhe ndërkombëtar (pjesa e KQP 861) (përveç noterëve, përmbauesve privat dhe dokumentacionit ligjor dhe shërbimeve të ofruara për çertifikim, të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të cilëve u janë besuar funksionet publike) PII, PIII, PV, PVI, PVII	Modalitetet 1, 2, 3, 4 – Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 – Asnjë
Shërbimet e Kontabilitetit, Auditimit dhe Llogarimbajtjes (KQP 862) PII, PVI, PVII	Modaliteti 1 - Asnjë, përveç se raportet zyrtare të auditimit duhet të konfirmohen nga një firmë auditimi e regjistruar në jurisdikcionin vendas dhe të nënshkruhet nga një auditor i licencuar atje. Modalitetet 2, 3, 4 – Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë, përveç siç ceket në shtyllën e qasjes në treg.
Shërbimet Tatimore (KQP 863) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 – Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet Arkitekturale (KQP 8671) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 – Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet inxhinierike (KQP 8672) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 – Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet e integruara inxhinierike (KQP 8673) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 – Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë

Shërbimet arkitekturale të planifikimit urban dhe peizazhit (KQP 8674) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 – Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet mjekësore dhe dentare (duke përjashtuar institucionet e shëndetit publik (KQP9312) PI, PII, PIII, PV, PVI, PVII	Modalitetet 1, 2, 3, 4 – Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet veterinare (KQP 932), duke përjashtuar institucioneve publike Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 – Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet e personelit të mamive, infermiereve, fizioterapistëve dhe personelit paramedik (KQP 93191) duke përjashtuar institucionet e shëndetit publik Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet Kompjuterike dhe të Ngjashme Computer and Related Services (KQP 84) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 – Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet kërkimore dhe zhvillimore (KQP 851-853) PI, PII, PIV, PV, PVI, PVII	Modalitetet 1, 2, 3, 4 – Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet e Pronës së Paluajtshme (KQP 821 & 822) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 – Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet e Marrjes me Qira ose Dhënies me Qira pa Operator (KQP 83) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 – Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë

Marrja ose dhënia me qira e pajisjeve për inçizim në studio (KQP 83109)** Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 – Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet propagandistike (KQP 871) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 – Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet për hulumtimin e tregut dhe sondazhin e opinionit publik (KQP 864) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet për këshillim të menaxhimit (KQP 865) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet për këshillim dhe menaxhim (KQP 866) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet e testimit dhe analizës teknike (KQP 8676) (Duke përjashtuar shërbimet që lidhen me lëshimin e certifikatave të detyrueshme dhe dokumenteve të ngjashme zyrtare me përjashtim të atyre për të cilat është paraparë njohja e vlefshmërisë së certifikatave ose dokumenteve të një Pale tjetër). Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modes 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet këshillimore që kanë të bëjnë vetëm me bujqësi dhe pylltari (pjesa e KQP 881) PII, PV, PVI, PVII	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet këshillimore dhe konsultuese për gjuetinë (pjesa e KQP 881) PII, PV, PVI, PVII	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë

Shërbimet këshillimore dhe konsultuese për peshkimin (pjesa e KQP 882) PII, PV, PVI, PVII	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet që lidhen me shfrytëzimin e minierave (KQP 883) Puna për përgatitjen e vendpunishtes për shfrytëzim minierash (KQP 5115) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet që lidhen me prodhim (KQP 884) Shërbimet që lidhen me prodhimin e produkteve metalike, makinerive dhe pajisjeve (KQP 885) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet këshillimore dhe konsultuese për distribuim të energjisë (pjesa e KQP 887) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Vendosja dhe shërbimet e furnizimit të personelit (KQP 872) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet për këshillim shkencor dhe teknik (KQP 8675) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve (KQP 633+8861 to 8866) Mirëmbajtja dhe riparimi i motoçikletave dhe sajave motorike (KQP 6122) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë

Shërbimet për pastrimin e ndërtesave (KQP 874) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modes 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modes 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet fotografike (KQP 875) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet e paketimit (KQP 876) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shtypja dhe publikimi (88442), duke përjashtuar shtypjen dhe publikimin e Gazetës Zyrtare Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet për takime – Planifikimi, menaxhimi dhe marketingu për takime dhe ngjarje të ngjashme (KQP 87909*) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet e përkthimit dhe interpretimit (KQP 87905) duke përjashtuar shërbimet e interpretuesve të betuar Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet e dizajnit special (KQP 87907*) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet e flokëtarëve dhe berberëve (KQP 97021) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë

2. SHËRBIMET E KOMUNIKIMEVE

Shërbimet Postare dhe Koriere ⁴⁸ (KQP 68)		
<p>(i) Shërbimet Postare për letra (KQP 68111):</p> <p>Shërbimet për grumbullim, transport dhe shpërndarje të gazetave, revistave dhe publikimeve periodike, qoftë për destinime vendore ose të huaja, përveç atyre që ofrohen nën detyrimin e shërbimit universal.</p> <p>(ii) Shërbimet për grumbullim, transport dhe shpërndarje të letrave, broshurave, fletëpalosjeve dhe shtypjeve të ngjashme, qoftë për destinime vendore ose të huaja, përveç atyre që ofrohen nën detyrimin e shërbimit universal, duke përjashtuar artikujt më pak se 350 gram në peshë dhe çmimi i të cilëve është më pak se pesëfishi i tarifës bazë publike, duke përjashtuar shërbimin postar të regjistruar që përdoret në procedurën gjyqësore ose administrative.</p> <p>(iii) Shërbimet Postare për pako (KQP 68112):</p> <p>Shërbimet për grumbullim, transport dhe shpërndarje të pakove dhe paketimeve, qoftë për destinime vendore ose të huaja, përveç atyre që ofrohen nën detyrimin e shërbimit universal, duke përjashtuar artikujt më pak se 350 gram në peshë dhe çmimi i të cilëve është më pak se pesëfishi i tarifës bazë publike, duke përjashtuar shërbimin postar të regjistruar që përdoret në procedurën gjyqësore ose administrative.</p>	Modaliteti 1,2,3,4 Asnjë	Modaliteti 1,2,.3,.4 Asnjë

⁴⁸ Bazuar në Versionin 2 të KQP (Publikim i Kombeve të Bashkuara ST/ESA/STAT/SER.M/77/Ver.2).

<p>Shërbimet Koriere (KQP 6812)</p> <p>(i) Shërbimet për grumbullim, transport dhe shpërndarje, qoftë për destinime vendore ose të huaja, për letra, pako dhe paketime, të ofruara nga korieri dhe duke përdorur një ose më shumë modalitete të transportit, përveç atyre që ofrohen nën detyrimin e shërbimit universal.</p> <p>(ii) Shërbimet e korierit, që ofrohen nga korierë me motoçikleta.</p> <p>(iii) Shërbimet e shpërndarjes lokale të artikujve si ushqimi dhe blerjet tjera (KQP 6813).</p> <p>Të gjitha Palët e CEFTA-s</p>	<p>Modaliteti 1,2,3,4, Asnjë</p>	<p>Modaliteti 1,2,3,4 Asnjë</p>
<p>Shërbimet e Telekomunikacionit dhe Ofrimit të Informatave</p>		
<p>Shërbimet e telefonisë dhe ato të telekomunikacionit (KQP 841)⁴⁹</p>		
<p>Shërbimet Bartëse (KQP 8411)</p> <p>Shërbimet e telefonisë fikse (KQP 8412)</p> <p>Shërbimet e telekomunikacionit mobil (KQP 8413)</p> <p>Shërbimet e rrjetit privat (KQP 8414)</p> <p>Shërbimet për transmetimin e të dhënave (KQP 8415)</p> <p>Shërbimet tjera të telekomunikacionit (KQP 8419)</p> <p>Të gjitha Palët e CEFTA-s</p>	<p>Modaliteti 1,2,3,4 Asnjë</p>	<p>Modaliteti 1.2.3.4 Asnjë</p>

⁴⁹ Bazuar në Versionin 2 të KQP (Publikim i Kombeve të Bashkuara ST/ESA/STAT/SER.M/77/Ver.2).

Shërbimet e telekomunikacionit në internet (KQP 842) ⁵⁰ Shërbimet e rrjetit kryesor (KQP 8421) Shërbimet për qasje në internet (KQP 8422) Shërbimet tjera të telekomunikacionit në internet (KQP 8429) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modaliteti 1,2,3,4 Asnjë	Modaliteti 1,2,3,4 Mode
Përmbajtja në internet (KQP 843) ⁵¹ Të gjitha Palët e CEFTA-s	Modaliteti 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modaliteti 1, 2, 3, 4 - Asnjë

⁵⁰ Bazuar në Versionin 2 të KQP (Publikim i Kombeve të Bashkuara ST/ESA/STAT/SER.M/77/Ver.2).

⁵¹ Bazuar në Versionin 2 të KQP (Publikim i Kombeve të Bashkuara ST/ESA/STAT/SER.M/77/Ver.2).

3. SHËRBIMET E NDËRTIMIT DHE ATO TË NGJASHME INXHINIERIKE		
<p>Puna e montimit në vendpunishte (KQP 511)</p> <p>Punët ndërtimore në ndërtesa (KQP 512)</p> <p>Puna ndërtimore për ndërtimtari të rrugëve, urave, etj. (KQP 513)</p> <p>Montimi dhe ngritja e ndërtimeve të parafabrikuara (KQP 514)</p> <p>Punët e veçanta ndërtimore për tregti (KQP 515)</p> <p>Puna e instalimit (KQP 516)</p> <p>Përfundimi i ndërtimit dhe punimet e mbarimit (KQP 517)</p> <p>Shërbimet për marrjen me qira të pajisjeve për ndërtim ose shembje të ndërtesave ose për punët e ndërtimit të rrugëve, urave etj, me operator (KQP 518)</p> <p>Të gjitha Palët e CEFTA-s</p>	<p>Modaliteti 1,2,3,4 Asnjë</p>	<p>Modaliteti 1,2,3,4 Asnjë</p>
4. SHËRBIMET E DISTRIBUIMIT		
<p>(Ver. 2 i KQP, Pjesët 61 & 62, duke përjashtuar tregtinë e eksplozivëve, armëve dhe municionit dhe, për PVI, tregtinë e organizmave gjenetikiisht të modifikuar)</p> <p><u>Shërbimet e tregtisë me shumicë</u></p> <p>Shërbimet e tregtisë me shumicë, përveç në bazë të tarifës ose kontratës</p> <p>Shërbimet e tregtisë me shumicë në bazë të tarifës ose kontratës</p> <p><u>Shërbimet e tregtisë me pakicë</u></p> <p>Shërbimet e tregtisë me pakicë të dyqaneve të jospecializuara</p>	<p>Modaliteti 1,2,3,4 Asnjë</p>	<p>Modaliteti 1,2,3,4 Asnjë</p>

<p>Shërbimet e tregtisë me pakicë të dyqaneve të specializuara</p> <p>Shërbimet e tregtisë me pakicë përmes porosisë me postë ose në internet</p> <p>Shërbimet tjera të tregtisë me pakicë pa dyqane</p> <p>Shërbimet e tregtisë me pakicë në bazë të tarifës ose kontratës</p> <p>Të gjitha Palët e CEFTA-s</p>		
5. SHËRBIMET ARSIMORE		
<p>(Vetëm shërbimet me financim privat)</p> <p>Shërbimet e arsimit fillor (KQP 921)</p> <p>Shërbimet e arsimit të mesëm (KQP 922)</p> <p>Shërbimet e arsimit të lartë (KQP 923)</p> <p>Arsimi i të rriturve (KQP 924)</p> <p>Shërbimet tjera arsimore (KQP 929)</p> <p>PI, PII, PIV, PV, PVI, PVII</p>	<p>Modaliteti 1,2,3,4 Asnjë</p>	<p>Modaliteti 1,2,3 4 Asnjë</p>
6. SHËRBIMET MJEDISORE		
<p>A. Menaxhimi i ujërave të zeza (shërbimet për ujërat e zeza korrespondojnë me shërbimet e kanalizimit) (KQP 9401)</p> <p>B. Menaxhimi i mbeturinave të ngurta/të rrezikshme</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shërbimet për largim të mbeturinave (KQP 9402) - Shërbimet sanitare dhe të ngjashme (KQP 9403) <p>C. Mbrojtja e ajrit dhe klimës së ambientit:</p>	<p>Modaliteti 1,2,3 4 Asnjë</p>	<p>Modaliteti 1,2,3 4 Asnjë</p>

<p>- Shërbimet për pastrim të gazrave të shkarkuara (KQP 9404)</p> <p>D. Rehabilitimi dhe pastrimi i tokës dhe ujërave:</p> <p>- Trajtimi, rehabilitimi i tokës dhe ujërave të kontaminuar/ndotura (pjesa e KQP 9406)</p> <p>Korrespondon me pjesët e shërbimeve për mbrojtje të natyrës dhe peizazhit.</p> <p>E. Ulja e zhurmës dhe dridhjeve (KQP 9405)</p> <p>F. Mbrojtja e biodiversitetit dhe peizazhit:</p> <p>- Shërbimet për mbrojtje të natyrës dhe peizazhit (pjesë të KQP 9406 që nuk përfshihen nën D)</p> <p>G. Shërbime të tjera mjedisore (KQP 9409)</p> <p>H. Shërbimet për Këshillim Mjedisor (KQP 83931)</p> <p>Të gjitha Palët e CEFTA-s</p>		
7. SHËRBIMET FINANCIARE		
<p><u>Shërbimet e sigurimit dhe ato që lidhen me sigurim, KQP 812</u></p> <p>PVII</p>		
<p>Shërbimet për sigurimin e jetës, aksidenteve dhe shëndetit, (KQP 8121)</p>	<p>Modaliteti 1 – I padetyrueshëm</p> <p>Modalitetet 2, 3, 4 - Asnjë</p>	<p>Modaliteti 1 - I padetyrueshëm</p> <p>Modalitetet 2, 3, 4 - Asnjë</p>
<p>Shërbimet për sigurim të përgjithshëm (KQP 8129)</p> <p>(Përveç për rastet e sigurimit të rreziqeve që lidhen me transportim detar apo ajror dhe kur rreziku nuk përfshihet nga kompania vendore ose dega e kompanisë së Palës tjetër, e cila e ushtron veprimtarinë e saj PVII (Kompania duhet të jetë e regjistruar në PVII).</p>	<p>Modaliteti 1 - I padetyrueshëm</p> <p>Modalitetet 2, 3, 4 - Asnjë</p>	<p>Modaliteti 1 - I padetyrueshëm</p> <p>Modalitetet 2, 3, 4 - Asnjë</p>
<p>Risigurimi dhe rikthimi (KQP 81299*)</p> <p>(Vetëm për rreziqet të cilat i sigurojnë kompanitë e sigurimeve të Palës tjetër dhe për rreziqet që risiguruesit vendor nuk mund t'i mbulojnë vet. Në bazë të rregullave vendore të Bankës Qendrore të</p>	<p>Modaliteti 1 - I padetyrueshëm</p> <p>Modalitetet 2, 3, 4 - Asnjë</p>	<p>Modaliteti 1 - I padetyrueshëm</p> <p>Modalitetet 2, 3, 4 - Asnjë</p>

<p>PVII, kompanitë e sigurimeve nuk mund ta marrin rrezikun për një ngjarje e cila tejkalon 10% të kapitalit të tyre.)</p>		
<p>Shërbimet ndihmëse të sigurimit (përfshirë shërbimet e ndërmjetësimit dhe të agjencive) (KQP 8140)</p>	<p>Modaliteti 1 - I padetyrueshëm Modalitetet 2, 3, 4 - Asnjë</p>	<p>Modaliteti 1 - I padetyrueshëm Modalitetet 2, 3, 4 - Asnjë</p>
<p>Shërbimet bankare dhe shërbimet e tjera financiare (përveç sigurimit) PVII</p>		
<p>a. Pranimi i depozitave dhe fondeve të tjera të ripagëshme nga publiku b. Huadhënia e të gjitha llojeve, përf. në mes tjerash, kreditë konsumatore, kreditë hipotekare, faktorizimin dhe financimin e transaksioneve tregtare c. Lizingu financiar d. Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave e. Garancitë dhe zotimet f. Tregtimi për llogari personale ose për llogari të konsumatorëve, qoftë për këmbim, në tregun jashtë bursës ose në ndonjë mënyrë tjetër, si në vijim: - instrumentet e tregut të parave (çeqe, fatura, çertifikata e depozitave, etj.) - këmbimi ndërkombëtar - instrumentet e kursit të këmbimit dhe norma e interesit, përfshirë produktet si shkëmbime, marrëveshje të normës së afatit, etj. g. Pjesëmarrja në lëshimin e të gjitha llojeve të letrave me vlerë, përfshirë nënshkrimin dhe</p>	<p>Modaliteti 1 - I padetyrueshëm Modaliteti 2 - Asnjë Modaliteti 3 – Vetëm bankat e licencuara dhe institucionet tjera financiare. Modaliteti 4 - Asnjë</p>	<p>Modaliteti 1 - I padetyrueshëm Modalitetet 2, 3, 4 - Asnjë</p>

<p>vendosjen si agjent (qoftë publikisht ose privatisht) dhe ofrimi i shërbimit lidhur me çështjet e tilla</p> <p>h. Ndërmjetësimi në para</p> <p>i. Shërbimet për menaxhim të aktiveve, siç është menaxhimi i parave ose portofolit, të gjitha format për menaxhim të investimeve kolektive, menaxhimi i fondit pensional, dhe shërbimet për depozitim të kujdestarisë dhe besimit</p> <p>j. Shërbimet për shlyerje dhe pastrim për aktivet financiare, përfshirë letrat me vlerë, produktet derivative dhe instrumentet tjera të negociueshme</p> <p>k. Shërbimet këshillimore dhe të tjera ndihmëse, përfshirë referencën dhe analizën e kredive, hulumtimin dhe këshillimin e investimeve dhe portofolit, këshillat mbi blerjen dhe ristrukturimin dhe strategjinë e korporatës</p> <p>l. Ofrimi dhe bartja e informatave dhe përpunimi i të dhënave financiare dhe softuerët përkatës nga ofruesit e shërbimeve të tjera financiare.</p>		
8. SHËRBIMET SHËNDETËSORE DHE SOCIALE		
<p>(vetëm shërbimet e financuara private)</p> <p>Shërbimet spitalore⁵² (KQP 9311)</p> <p>Shërbimet tjera të shëndetit njerëzor (KQP 9319)</p> <p>PVII</p>	<p>Modaliteti 1 - I padetyrueshëm</p> <p>Modalitetet 2, 3, 4 - Asnjë</p>	<p>Modaliteti 1 - I padetyrueshëm</p> <p>Modalitetet 2, 3, 4 - Asnjë</p>
9. SHËRBIMET TURISTIKE DHE TË UDHËTIMEVE		

⁵² Veprimtaritë e shëndetit privat nuk lejohen në fushat në vijim: grumbullimi i gjakut dhe derivateve të tij; shërbimet e mjekësisë ligjore dhe të autopsisë; shërbimet e epidemiologjisë (përveç dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit parandalues), ekologjisë njerëzore dhe mikro-biologjisë mjedisore.

<p>Hotelet dhe restaurantet, përfshirë furnizimin me ushqim (KQP 641-643)</p> <p>Shërbimet e agjencive turistike dhe operatorëve të tureve (KQP 7471)</p> <p>Shërbimet e ciceronëve (KQP 7472)</p> <p>Të gjitha Palët e CEFTA-s</p>	<p>Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p> <p>PI – Kërkesa për ciceronët për një vit qëndrimi. PII, PIII, PVI, PVII – kërkesa për shtetësi dhe qëndrim për ciceronët.</p>	<p>Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë, përveç siç është cekur në shtyllën e qasjes në treg.</p>
---	--	---

10. SHËRBIMET REKREATIVE, KULTURORE DHE SPORTIVE		
<p>A. Shërbimet e argëtimit (shërbimet e teatrit, grupeve që performojnë drejtpërdrejtë dhe ato të cirkut) (KQP 9619)</p> <p>B. Shërbimet e agjencive të lajmeve (KQP 962)</p> <p>C. Shërbimet e bibliotekave, arkivave, muzeve dhe shërbimet e tjera kulturore (KQP 963)</p> <p>D. Shërbimet sportive dhe shërbimet tjera rekreative (KQP 964) (duke përjashtuar bastet dhe lojërat e fatit për Modalitetin 1).</p> <p>PVII</p>	<p>Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p>	<p>Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p>
11. SHËRBIMET E TRANSPORTIT (duke përjashtuar lundrimin anës detit)		
<p><u>A. Shërbimet e Transportit Detar</u></p> <p>a. Transportimi i udhëtarëve, (KQP 7211)</p> <p>b. Transportimi i mallrave, (KQP 7212)</p> <p>PVII</p>	<p>Modaliteti 1 - (a) Transporti i anijës linjë: Asnjë</p> <p>b) Transporti me shumicë, transportuesi dhe transporti ndërkombëtar, përfshirë transportimin e udhëtarëve: Asnjë</p> <p>Modaliteti 2 - Asnjë</p> <p>Modaliteti 3 - (a) Themelimi i kompanisë së regjistruar me qëllim të funksionimit të flotës nën flamurin e PVI: I padetyrueshëm.</p> <p>(b) Forma tjera të pranisë komerciale për ofrim të shërbimeve për transport ndërkombëtar detar: Asnjë.⁵³</p>	<p>Modaliteti 1 - Asnjë</p> <p>Modaliteti 2 - Asnjë</p> <p>Modaliteti 3 - (a) I padetyrueshëm (b) Asnjë</p> <p>Modaliteti 4 - (a) Ekipazhet e anijes: I I padetyrueshëm (b) Asnjë</p>

⁵³ “Format tjera të pranisë komerciale për ofrim të shërbimeve ndërkombëtare për transport detar ” nënkuptojnë mundësinë për ofruesit e shërbimeve ndërkombëtare për transport detar të palëve të tjera të ndërmarrin në nivel vendor të gjitha aktivitetet e nevojshme për të furnizuar konsumatorët e tyre me shërbim të transportit të integruar pjesërisht ose plotësisht, në kuadër të të cilit transporti detar përbën një element qenësor. (Por ky zotim nuk duhet të interpretohet në asnjë mënyrë që i kufizon zotimet e marra nën modalitetin e ofrimit ndërkufitar.)

	Modaliteti 4 - (a) Ekipazhet e anijes: I padetyrueshëm; (b) Asnjë	
<u>E. Shërbimet e Transportit hekurudhor</u>		
a. Transportimi i udhëtarëve (KQP 7111) b. Transportimi i mallrave (KQP 7112) c. Shërbimet e shtyrjes dhe tërheqjes (KQP 7113) PVII	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Modalitetet 1, 2, 3, 4 - Asnjë
<u>F. Shërbimet e Transportit Rrugor</u>		
a. Transportimi i udhëtarëve (KQP 7121+7122) b. Transportimi i mallrave (KQP 7123) c. Marrja me qira e automjeteve tregtare me operator (KQP 7124) d. Mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve për transport rrugor, (KQP 6112+8867) e. Shërbimet mbështetëse për shërbimet e transportit rrugor (KQP 744) PVII	Modaliteti 1 - I padetyrueshëm Modalitetet 2, 3, 4 - Asnjë	Modaliteti 1 - I padetyrueshëm Modalitetet 2, 3, 4 - Asnjë